INDEP
INSTITUTE FOR DEVELOPMENT POLICY
INSTITUTI PËR POLITIKA ZHVILLIMORE

Reforma pensionale: alternativat nuk mungojne, cila është e duhura?

Raport i Fokus Grupeve

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Ministry of Foreign Affairs of Denmark
DANIDA | International
Development Cooperation

Reforma pensionale: alternativat nuk mungojne, cila është e duhura?

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm**

Data e publikimit: **Gusht 2018**

Foto e ballinës: **VisualHunt**

Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

"Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së."

Përmbajtja

Hyrje 2
Metodologjia 3
Rezultatet e pesë fokus grupeve të para 5
Unifikimi i skemave në një sistem/ligj të vetëm 5
Definimi i pensionit bazik 5
Njohja e përvojës së punës 5
Krijimi i fondit pensional dhe alternativisht trusti 6
Pensionet e dyfishta dhe përfitimi nga dy e më shumë skema 6
Gjykata e Strasburgut 6
Rezultatet nga fokus grupi me përfaqësuesit e personave me nevoja të veçanta 7
Definimi i pensionit 7
Unifikimi i ligjit për të gjitha kategoritë e personave me nevoja të veçanta 7
Pensionet 7
Kompensimet 7
Mbështetja në punësimin e personave me nevoja të veçanta 7
Rezultatet nga fokus grupi me ekspertët 8
Shtyllat e pensionit 8
Njohja e përvojës para vitit '99 8
Pensionet e FSK-së dhe Policisë 9
Paraqitja periodike e pensionistëve/Lajmërimi i pensionistëve që vdesin 9
Anekset 10
Transkriptat e fokus grupeve 10

Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP ka tri vite që është i angazhuar në gjetjen e zgjidhjeve alternative bazuar në hulumtime dhe analiza të pavarura sa i përket sistemit social dhe pensioneve. Përgjatë tri viteve, si pjesë e programit për Zhvillim të Qëndrueshëm, INDEP ka marrë për bazë krahasimi sistemet e vendeve të caktuara evropiane si edhe ato të rajonit, për t'i nxjerrë praktikat më të mira që do të mund të integrohen edhe në sistemin e Kosovës.

Në vazhdimësi të këtij angazhimi, INDEP është duke e zbatuar projektin "Reforma e Sistemit Pensional në Kosovë", projekt i financuar nga projekti "Promovimi i Shoqërisë Demokratike" (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Në kuadër të këtij projekti, INDEP ka realizuar 7 fokus grupe në 5 rajone të Kosovës me palë të interesit në fushën e sistemit pensional. Diskutimet gjatë fokus grupeve kanë sjellë opinione dhe propozime të ndryshme, të cilat në tërësi kanëdhënë propozime të ndryshme, megjithatë INDEP vlerëson se diversiteti i propozimeve që janë ofruar i kontribuon shumë procesit të reformimit të sistemit pensional për shkak se mund të konsultohen pikëpamje të ndryshme për ta gjetur modelin më të mirë.

Diskutimet e fokus grupeve kryesisht kanë prekur çështjen e njohjes së përvojës së punës para vitit 1999; pensionet kontributdhënës; skemat për personat me nevoja të veçanta; skemat për invalidë dhe veteranë të luftës, etj. Meqenëse kishte shumë propozime, të cilat janë të elaboruara detajisht më poshtë në raport, këtu përmenden vetëm kyçet.

Rezultatet e fokus grupeve kanë sugjeruar që reforma e sistemit pensional të sjellë një ligj të barabartë për secilin qytetar të Kosovës; të largohen skemat e veçanta që japin precedent për krijimin e skemave tjera ku vetëm një kategori favorizohet.Po ashtu, unanimisht është kërkuar që të njihet përvoja e punës e atyre personave që janë larguar nga puna gjatë viteve '90. Sa i përket kriterit 15 vite, ka pasur propozime të ndryshme që variuan prej uljes së kriterit në 10 vite e deri te përshkallëzimi i tij në raport me vitet e punës. Në të gjitha fokus grupet u propozua që të themelohet Fondi Pensional në mënyrë që t'i hiqet barra buxhetit të shtetit për pagimin e pensioneve. Sa i përket kategorisë së personave me nevoja të veçanta, u propozua që të definohen pensionet që jipen pas moshës 65 vjeçare dhe kompensimet që jipen për shërbimet mujore. Kompensimet u kërkua të jenë bazuar në nevojat e secilës kategori pasi secila kategori ka nevoja të ndryshme dhe nuk mund të plotësohen me kompensime të njëjta.

Raporti në vijim do t'i pasqyrojë të gjitha propozimet dhe sugjerimet e dhëna të grupuara varësisht kategorisë dhe problemeve të adresuara.

Metodologjia

Për nxjerrjen e të dhënave për këtë dokument është përdorur hulumtimi kualitativ, përkatësisht metoda e fokus grupeve. Për të marrë një pasqyrë sa më gjithëpërfshirëse të opinioneve dhe propozimeve të palëve të interesit për reformën e sistemit pensional, pjesëmarrësit e fokus grupeve fillimisht janë përzgjedhur nga të gjitha grupet e interesit të Ligjit për Pensione dhe kanë përfshirë të gjitha rajonet e Kosovës. Pra, fokus grupet janë mbajtur në 5 rajone të Kosovës, përkatësisht komunat e rajonit të Gjilanit janë përfshirë në fokus grupin e mbajtur në Gjilan, dhe njëjtë ka vlejtur edhe për rajonin e Mitrovicës, Gjakovës, Prizrenit dhe Prishtinës.

Metoda e përzgjedhjes së pjesëmarrësve të pesë Fokus Grupeve të para konsiston në përfituesit direktë/aktual të Ligjit për Pensione si dhe në organizatat/shoqatat e angazhuara në këtë fushë. Duke e pasur parasysh që shumë nga këta pjesëmarrës bëjnë pjesë në kategori të ndryshme të Ligjit për Pensione, e disa prej tyre janë përfitues të më shumë se një skeme; INDEP e konsideroi relevante qëkjo kategori të ishte pala kryesore në fokus grupe në të 5 rajonet. INDEP, po ashtu, u përkujdes që në secilin fokus grup të kishte pjesëmarrës edhe palën tjetër, atë të institucioneve vendimmarrëse, përkatësisht Divizionet Rajonale për Pensione përkatëse për secilin rajon. Kjo u bë për arsye që diskutimi të ishte sa më i balancuar dhe propozimet e dhëna nga përfituesit të kishin paraprakisht parasysh mundësitë aktuale për t'u realizuar.

Ndërkaq, pjesëmarrësit e dy fokus grupeve të fundit u përzgjodhën me kriter të ndryshëm për shkak të relevancës ndaj çështjes në diskutim. Njëri nga dy fokus grupet e fundit i mblodhi përfaqësuesit e skemës sociale për personat me nevoja të veçanta, ndërkaq fokus grupi i fundit përzgjodhi pjesëmarrësit që vlerësohet të jenë ekspertë të fushës së pensioneve.

Balanca gjinore ka qenë në disavantazh të diskutimeve pasi në pozicione përkatëse drejtuese qoftë në institucione ose shoqata/lidhje kanë qenë shumica meshkuj. Në të gjitha fokus grupet, pra 7 prej tyre, të pranishme kanë qenë vetëm 14 femra.

Temat e fokus grupit janë përzgjedhur me kujdes dhe moderatori është kujdesur që të mbajë strukturën e diskutimit të hapur dhe të pa ndikuar. Në të gjitha fokus grupet e mbajtura, përveç në atë me personat me nevoja të veçanta, ku temat kanë qenë më specifike, temat kanë qenë të njëjta. Pas përfundimit të fokus grupit, materiali audio është transkriptuar, pastruar dhe është analizuar. Janë analizuar motivet kryesore të diskutimit, citatet më të spikatura, idetë më të diskutuara përfshirë thellësinë dhe pajtueshmërinë ose kundërshtimin e ideve etj.

Më datë 26.06.2018 është mbajtur fokus grupi në Gjilan me 18 pjesëmarrës nga qyteti i Gjilanit, Vitisë, Shtimes dhe Kamenicës. Diskutimi ka zgjatur mbi 2 orë dhe secili nga të pranishmit i ka shprehur propozimet e veta. Shumica e pjesëmarrësve kanë qenë përfitues të skemave pensionale, respektivisht të angazhuar njëkohësisht në lidhje/sindikata për të drejtat e pensionistëve/invalidëve të punës; ndërkaq rreth 4 persona kanë qenë përfaqësues të Drejtorisë për Pensione për Rajonin e Gjilanit.

Më datë 27. 06. 2018 është mbajtur fokus grupi në Prizren me 8 pjesëmarrës nga qyteti i Prizrenit, Rahovecit dhe Suharekës. Diskutimi ka zgjatur mbi 2 orë dhe secili nga të pranishmit i ka shprehur propozimet e veta. Shumica e pjesëmarrësve kanë qenë përfitues të skemave pensionale, respektivisht të angazhuar njëkohësisht në lidhje/sindikata për të drejtat e pensionistëve/invalidëve të punës; ndërkaq rreth 3 persona kanë qenë përfaqësues të Drejtorisë për Pensione për Rajonin e Prizrenit.

Më datë 28. 06. 2018 është mbajtur fokus grupi në Gjakovë me 12 pjesëmarrës nga qyteti i Gjakovës, Deçanit dhe Junikut. Diskutimi ka zgjatur mbi 2 orë dhe secili nga të pranishmit i ka shprehur propozimet e veta. Shumica e pjesëmarrësve kanë qenë përfitues të skemave pensionale, respektivisht të angazhuar njëkohësisht në lidhje/sindikata për të drejtat e pensionistëve/invalidëve të punës; ndërkaq 2 persona kanë qenë përfaqësues të Drejtorisë për Pensione për Rajonin e Gjakovës.

Më datë 11. 07. 2018 është mbajtur fokus grupi në Mitrovicë me 15 pjesëmarrës nga qyteti i Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skenderajit. Diskutimi ka zgjatur mbi 2 orë dhe secili nga të pranishmit i ka shprehur propozimet e veta. Shumica e pjesëmarrësve kanë qenë përfitues të skemave pensionale, respektivisht të angazhuar njëkohësisht në lidhje/sindikata për të drejtat e pensionistëve/invalidëve të punës; ndërkaq 1 person ka qenë përfaqësues të Drejtorisë për Pensione për Rajonin e Mitrovicës. Në këtë fokus grup specifika ka qenë që tre nga pjesëmarrësit kanë qenë të moshës relativisht të re të cilët i kanë shtuar vlerë diskutimit për shkak që i përkasin krejtësisht një gjenerate të re që janë përfituesit e ardhshëm të Ligjit për Pensione.

Më datë 18. 07. 2018 është mbajtur fokus grupi në Prishtinë me 10 pjesëmarrës nga qyteti i Prishtinës dhe Obiliqit. Diskutimi ka zgjatur mbi 2 orë dhe secili nga të pranishmit i ka shprehur propozimet e veta. Shumica e pjesëmarrësve kanë qenë përfitues të skemave pensionale, respektivisht të angazhuar njëkohësisht në lidhje/sindikata për të drejtat e pensionistëve/invalidëve të punës.

Më datë 19. 07. 2018 është mbajtur fokus grupi në Prishtinë me 10 pjesëmarrës nga organizatat/aktivistët për të drejtat e personave me nevoja të veçanta. Diskutimi ka zgjatur mbi 2 orë dhe secili nga të pranishmit i ka shprehur propozimet e veta. Disa nga pjesëmarrësit kanë qenë edhe përfitues të skemave pensionale për persona me nevoja të veçanta, respektivisht të angazhuar njëkohësisht në lidhje/sindikata për të drejtat e pensionistëve/invalidëve të punës.

Më datë 20. 07. 2018 është mbajtur fokus grupi në Prishtinë me 7 ekspertë të fushës së pensioneve. Diskutimi ka zgjatur mbi 2 orë dhe secili nga të pranishmit i ka shprehur propozimet e veta. I pranishëm ishte edhe një përfaqësues i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Rezultatet e pesë fokus grupeve të para

Numri i pjesëmarrësve							
Gjilan	**Prizren**	**Gjakovë**	**Mitrovicë**	**Prishtinë**	**Përfaqësuesit e OPNV**	**Ekspertë**	**Gjithsej**
18	8	12	15	10	10	8	81

Institucionet/Organizatat Pjesëmarrëse
Lidhja e Pensionistëve
Federata e Sindikalistëve
Bashkësia e Sindikatave të Bashkuara
Drejtoritë Rajonale të Pensioneve
Sindikatat e veçanta
Fondi Monetar Ndërkombëtar
MPMS
Përfitues të pavarur

1. Unifikimi i skemave në një sistem/ligj të vetëm

Të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan që të gjitha skemat pensionale ekzistuese duhet të unifikohen në një ligj të vetëm, kjo pasi skemat e veçanta ekzistuese, sipas tyre, janë diskriminuese për kategoritë e papërfshira dhe shkaktojnë kaos brenda sistemit pensional.

2. Definimi i pensionit bazik

Nga të gjitha diskutimet e fokus grupeve rezultoi sugjerimi që shuma e parave që e marrin pas moshës 75 vjeçare (pa kontribute), nuk duhet të quhet pension por ndihmë socialë e pleqërisë. Disa kërkuan që të quhet pension social. Gjithashtu dominoi mendimi qe pensioni bazik te jete i testueshem ne te hyra personale.

3. Njohja e përvojës së punës

Njohja e kontributeve/përvojës së punës para vitit ’99 ishte njëra ndër temat kyçe që u diskutua nga pjesëmarrësit e fokus grupeve, sidomos pese fokus grupeve të para. Nga të gjithë ligji aktual u cilësua diskriminues. Ndonëse jo të gjithë pajtoheshin me vetëm një model, fryma e përbashkët e të gjitha diskutimeve ishte se përvoja e punës para viteve ’99 e të gjitha veprimtarive duhet të njihet, sidomos të larguarve nga puna në baza jo vullnetare. Propozimet kryesore ishin:
a) Të zbritet kriteri i 15 viteve në 10 ose në 5, duke përjashtuar ata që për disa ditë e muaj nuk e arrijnë këtë shifër,
b) Të përshkallëzohet njohja e përvojës së punës në bazë të secilit vit të përvojës së punës,

c) Të ndahet kriteri në 15 vite, 10 vite dhe 5 vite. Ata të cilët kanë deri në 5 vite përvojë pune ta marrin pensionin që u takon me një këst,
d) Të themelohet mekanizmi shtetëror për blerjen e përvojës së punës për ata të cilët nuk mund ta plotësojnë kriterin e vënë prej një numri të caktuar vitesh,
e) Pensioni kontributiv të mos bazohet në kualifikimin arsimor, por në kontributet e paguara,
f) Të merret për bazë edhe kualifikimi arsimor edhe pozita e punës,
g) Të merret përvoja e punës deri në vitin 2002.

4. Krijimi i fondit pensional dhe alternativisht trusti

Pothuajsë të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan që duhet të themelohet Fondi Pensional ku një gjeneratë do të paguante për tjetrën, megjithatë edhe ky sistem duhet të reformohet që t'i përshtatet kontekstit aktual. Kjo, sipas pjesëmarrësve, do t'ia hiqte barrën buxhetit të shtetit dhe pensioni kontributiv do të paguhej nga ky fond. Burimet e fondit u propozuan të ishin taksat në mallrat luksoze apo edhe të punësuarit të paguajnë një përqindje të të ardhurave në këtë fond. Pati edhe pjesëmarrës që e mbështetën idenë që trusti duhet të vazhdojë të ekzistojë për ata që duan të paguajnë në baza vullnetare.

5. Pensionet e dyfishta dhe përfitimi nga dy e më shumë skema

Sa i përket pensioneve të dyfishta, pra ata që përfitojnë pension edhe nga një vend tjetër, mendimet ndaheshin në dy grupe; i pari i cili ishte me dominues ishte kategorikisht kundër që një person të marrë dy pensione. Sipas tyre, ligji i ri duhet të ketë një mekanizëm që identifikon individët që përfitojnë pension edhe nga një shtet tjetër dhe t'i detyrojë ata ta zgjedhin njërin prej tyre. Grupi i dytë sugjeroi se nuk ekziston e drejta për ndalimin e përfitimit të dy pensioneve nga shtete të ndryshme; kjo sepse, sipas grupit të dytë, të gjithë ata përfitues i paguajnë të gjitha detyrimet ndaj shtetit dhe u takon pensioni bazik. Po ashtu, u përmend edhe rasti i serbëve që përfitojnë pension edhe nga Kosova dhe Serbia; sipas tyre me dispozitën për ta ndaluar pensionin e dyfishtë vetëm për shqiptarët, bëhet diskriminim në baza etnike. Ndërkaq, në çështjen e përfitimit të individëve nga dy e më shumë skema, pjesëmarrësit propozuan që skemat të unifikohen, por gjithnjë duke marrë për bazë që pensioni final që merret nga ta të përfshijë edhe një përqindje shtesë për kategorinë e veçantë së cilës i takon përfituesi. Pra pensioni bazë + përqindja për kategorinë. E njëjta u sugjerua për familjet e dëshmorëve. Disa të tjerë sugjeruan se në vend të përqindjes shtesë qeveria të ofrojë beneficione shtesë në formë shërbimesh dhe jo përmes mjeteve financiare. Sa i përket invaliditetit, pjesëmarrësit sugjeruan se të gjithe invalidët e punës duhet të paguhen në bazë të shkallës së invaliditetit + pensioni bazë pas moshës 65 vjeçare.

6. Gjykata e Strasburgut

Në të pesë fokus grupet e para, pjesëmarrësit pretenduan se ekziston një fondi i vjedhur nga Serbia dhe se është lëshuar një vendim nga Gjykata e Strasburgut lidhur me këtë çështje. INDEP propozon që MPMS ta rrisë nivelin e informimit tek publiku përfitues për këtë çështje pasi me anë të dezinformatave të tilla është krijuar një konfuzitet në mes përfituesve aktualë të pensionit, sidomos atyre që kanë qenë punëmarrës gjatë viteve '90, i cili ndikon që kërkesat dhe propozimet e tyre të mos jenë të realizueshme.

Rezultatet nga fokus grupi me përfaqësuesit e personave me nevoja të veçanta

Definimi i pensionit

Nga të pranishmit në fokus grup u kërkua që të bëhet qartë ndarja e pensioneve dhe kompensimeve dhe të dihet cila është cila. Propozimet variuan nga ajo që në reformën e sistemit pensional të përfshihet vetëm pensioni pas moshës 65 vjeçare, ndërkaq kompensimet që jipen para kësaj moshe të quhen kompensime. Sipas të pranishmëve, definimi i kompensimit që i jipet një personi me nevoja të veçanta në moshën 18 vjeçare si pension është term ofendues. Kompensimet, ndërkaq, të rregullohen me ligj të veçantë për personat me nevoja të veçanta.

Unifikimi i ligjit për të gjitha kategoritë e personave me nevoja të veçanta

Shumica e pjesëmarrësve kërkuan që të largohen skemat e veçanta që rregullojnë vetëm kategori të caktuara të personave me nevoja të veçanta dhe të bëhet një ligj që i rregullon të gjitha kategoritë bazuar specifikisht në nevojat e secilës kategori.

Pensionet

Sa i përket pensionit pas moshës 65 vjeçare, të pranishmit shfaqën kryesisht disa propozime:

a) Pas moshës 65 vjeçare të merret pensioni bazë/kontributiv por të mos ndalet kompensimi i bazuar në nevojat e kategorisë përkatëse.
b) Të rritet shuma e kompensimit pas moshës 65 vjeçare, por të mos merret edhe pensioni.
c) Të merret edhe pensioni i pleqërisë (ose një përqindje) dhe kompensimet.

Kompensimet

Kompensimet u kërkua të jenë bazuar në nevojat e secilës kategori pasi secila kategori ka nevoja të ndryshme dhe nuk mund të plotësohen me kompensime të njëjta. Sipas të pranishmëve, ligji aktual nuk i merr parasysh nevojat e secilës kategori, por për disa kategori përcakton kompensim të njëjtë çka e pamundëson zhvillimin normal të jetës së personit me nevoja të veçanta, i cili burim të vetëm financiar e ka këtë kompensim. Ndërkaq, në raste të tjera disa kategori privilegjohen. Në këtë kuptim, të pranishmit propozuan që qasja e barabartë për secilin person të kësaj kategorie të nënkuptojë që secilit t'i sigurohen kompensimet e duhura bazuar në nevojat respektive. Për shkak të mungesës së ofrimit të shërbimeve të domosdoshme për këtë kategori nga shteti, sipas tëpranishmëve, kompensimi duhet të përfshijë edhe kompensimin për shërbimet mujore të nevojshme.
Pati edhe propozim që të caktohet kompensimi i njëjtë për të gjitha kategoritë, po ashtu kompensim me vlerë të njëjtë për përcjellësin potencial.
Po ashtu, u propozua që të përshkallëzohet kompensimi varësisht shkallës së invaliditetit. Sa i përket invalidëve të punës, u propozua që përderisa shkalla e invaliditetit për punëështë më e vogël se 40%, t'i sigurohen lehtësime jo detyrimisht nëformë financiare, për integrimin e tij. Por, sipas të pranishmëve, gjithsesi edhe personi me shkallë të invaliditetit 40% të ketë kompensime. Ndërkaq, u propozua edhe që të gjithë personat me invaliditet mbi 80% të lirohen nga pagesat për shërbime.

Mbështetja në punësimin e personave me nevoja të veçanta

Të pranishmit e vlerësuan si shumë diskriminuese ndaljen e kompensimeve me rastin e punësimit të personave me nevoja të veçanta. Sipas tyre, megjithëse një të punësuari me nevoja të veçanta mund

t'i ulet kompensimi, atij nuk duhet t'i hiqet krejtësisht. Emërimi i kompensimit që i jipet një personi me nevoja të veçanta si pension që në moshën 18 vjeçare, sipas disa të pranishmëve, e privojnë personin nga qasja në tregun e punës pasi e shpallin të paaftë për punë. Po ashtu, u kërkua që t'u lejohet angazhimi në punë personave që kanë nivel të ulët të nevojave të veçanta dhe nuk kanë nevojë për shërbime mujore, respektivisht kompensim.

Rezultatet nga fokus grupi me ekspertët

Shtyllat e pensionit

Eksperti 1 propozoi që ligji i ri i pensioneve t'i ndjekë parimin e universalitetit, barazisë dhe solidaritetit. Sipas tij, pensioni minimal duhet të jetë në raport me mesataren e medianës në treg. Shtylla I, sipas tij, duhet ta përfshijë shtyllën 0 dhe fondin e sigurimeve pensionale dhe kjo shtyllë duhet të menaxhohet nga një institucion. Shtylla 0 duhet të kthehet në pension shtetëror dhe t'u jipet të gjithë atyre që pas moshës 65 vjeçare nuk kanë të ardhura tjera. Sipas tij, ky pension duhet të jetë i barabartë për të gjithë.

Të ardhurat e tjera, sipas Ekspertit 1, pra pensionet kontributdhënëse duhet të jipen nga buxheti i shtetit, përkatësisht të sigurohen nga fondi pensional. Sigurimet socialë duhet të financohen nga punëtorët dhe punëdhënësit aktualë. Kontributet për të dyja palët të rriten në 7%. Sipas tij, duhet të ruhet skema e kursimeve të obligueshme por të ulet kontributi që bëhet nga 5 + 5 në 2.5 + 2.5 = 5, pasi këto të ardhura në term afatgjatë janë të pasigurta, andaj për të pasur qëndrueshmëri afatgjatë duhet të zvogëlohen këto kontribute dhe të sigurohet kontributi që ka garanci qeveritare Zvogëlimi i këtij kontributi, sipas tij, interesi në treg për siguri rritet dhe shtohen edhe fondet mes shteteve të tjera dhe Kosovës. Pra, formula të jetë 14 + 5 + 7=26% në të ardhurat reale.

Eksperti 2 tha se ndërlidhja me pagën minimale bëhet më shumë për personat që punojnë, ndërkaq përfituesit e këtyre shtyllave janë jashtë tregut të punës, andaj u shpreh i rezervuar për këtë ndërlidhje. Ai propozoi që krahas kontributeve 5+5 të shtohet edhe 3+3 që arrin në 8+8. Ai nuk e përkrahi themelimin e fondit, sipas qëndrimeve të institucionit që e përfaqësoi, por se duhej vazhduar me shtyllën II.

Eksperti 3 e propozoi shembullin e Malit të Zi sa i përket kontributeve: punëdhënësi 8.5% + punëmarrësi 4.3% = 12.8%. Dhe pensionistët të paguajnë 1% për sigurime shëndetësore.

Eksperti 6 propozoi që Fondi Pensional të themelohet brenda Kosovës.

Eksperti 3 propozoi që të merret bazë paga minimale për përcaktimin e pensionit, pra të jetë 60% e pagës minimale.

Njohja e përvojës para vitit '99

Eksperti 2 tha se nëse u njihet të gjithëve përvoja e punës para vitit '99, edhe atyre që e kanë humbur vendin e punës, obligimi financiar bëhet shumë i madh, andaj ai e propozoi përpjestimin për vite të punës.

Eksperti 3 propozoi po ashtu që njohja e përvojës së punës të bëhet në përpjestim me vitet.

Eksperti 6 propozoi që kriteri të ulet prej 15 në 10 vjet ose të pranohet stazhi i të gjithëve prej 23 mars 1999. Ai, po ashtu, kërkoi që Neni 8, pika 6, ta njohë edhe kontributin dhe jo vetëm kualifikimin dhe përvojën.

Eksperti 5 tha se kriteri 15 vjet është shumë diskriminues kur e barazon përvojën 15 vjeçare me atë 40 vjeçare. Ai propozoi që të njihet secila orë e punës ose të njihet deri në vitin 2002. Ai e propozoi futjen e institucionit për blerjen e stazhit të munguar, sipas tij, kjo do ta ndihmonte edhe arkën e shtetit. Ai tha se dispozita "të tjerët" në ligj ishte shumë e qartë pasi përcaktonte të gjitha format e kontributit. Eksperti 5 po ashtu propozoi që kualifikimi të mirret parasysh dhe të mos kategorizohen njëjtë të kualifikuarit, të kualifikuarit e lartë dhe të pakualifikuarit.
Eksperti 3 propozoi që kontributet të paguhen në proporcion me vitet e punës, ata që kanë përvojë punë deri në 5 vite ta marrin atë që u takon me një këst nëse preferojnë ashtu.

Pensionet e FSK-së dhe Policisë

Eksperti 1 tha se duhet të caktohet se një anëtar i FSK-së dhe Policisë mund të dalë në pension kur t'i ketë mbushur minimum 60 vjet. Kjo sipas tij vjen për shkak së konteksti social tash ka ndryshuar dhe është rritur jetëgjatësia.
Eksperti 2 tha se skemat e veçanta për FSK-në dhe Policinë kanë krijuar bazë për nxjerrjen e shumë skemave tjera. Sipas tij, në rastin e policisë duhet të aplikohen kontribute shtesë dhe jo t'i lejojë dikujt të hyjë në polici në moshën 37 vjeçare dhe të dalë në pension në moshën 50 vjeçare duke marrë 70% të pagës. Sipas Ekspertit 2, duhet të rriten kontributet për shkak që policët dalin në pension më herët se të tjerët.

Paraqitja periodike e pensionistëve/Lajmërimi i pensionistëve që vdesin

Në të gjitha fokus grupet, përfshirë këtë të ekspertëve, është ngritur çështja e mungesës së efikasitetit të mekanizmave për identifikimit të keqpërdorimeve të pensioneve pas vdekjes së përfituesit, por edhe të kërkesës, sipas tyre, të panevojshme që pensionistët të paraqiten çdo 6 muaj. Sipas tyre, kjo duhet të largohet e tëra ose të bëhet që pensionisti të paraqitet vetëm njëherë në vit. Pjesëmarrësit e shfaqën nevojën e krijimit të një databaze ku do të kishin qasje të gjitha institucionet. Po ashtu, u propozua që si nxitës për familjet që t'i çlajmërojnë personat prej sistemit do të shërbente nëse i ofrohet familjes mbulimi i shpenzimeve të varrimit dhe shuma e dy pensioneve të përfituesit që ka ndërruar jetë.

Anekset

Transkriptat e fokus grupeve[1]

Fokus Grupi I

Gjilan

Moderatori:

Ne e kemi majtë një diskutim fillestar për pensione në Prishtinë, nuk e di a ka qenë dikush prej juve. Tash kemi fillu me dalë në terren me bisedu me përfaqësues të shoqatave, të lidhjes së pensionistve, federatës e ministrisë dhe tjerë që janë të interesum lidhur me procesin e reformës që ka fillu në ministri. Grupi punues është ba, besoj që prej lidhjes së pensionistëve edhe federatës është dikush në grupin punues. Që mu ni zani i juj osht me kanë edhe ju aty. Nuk e di a ju kanë ftu. Po me rëndësi me qenë pjesë e atij grupi; na jemi të interesum me marr mendimin e propozimet e juja dhe po shkojmë në regjione. Krejt po thojnë që reforma s'osht mirë, tash po dojna me ditë cka saktë me ndrru. E po dojmë me bo ni përmbledhje të propozimeve e me ia dërgu ministrisë, edhe vet me bo ni punim në mënyrë që ministria nashta i merr parasysh nëse ka lobim të duhun. Ideja osht me bisedu cka mu ndërru.

Tash e dimë që gjeneratat e vjetra e kanë kryesisht problemin me sistemin e vjetër që ka të bëjë me njohjen e përvojës së punës para luftës, mirëpo ideja osht mu ndërru krejt sistemi e jo vec disa aspekte. Ma s'pari janë pajtu ministria që sistemi duhet me u ndrru krejt, tash po kqyrin cka mu ndrru. Ma s'pari osht pensioni bazik, na e dimë që pensionin bazik prej 75 euro e marrin krejt që i kanë mbi 65 vjet, po prapë nuk e marrin krejt, se ata që marrin pensione prej 20 skemave të tjera pensionale, nuk kanë të drejtë me marrë pensionin bazik, po ata që marrin pensioneve prej shteteve tjera, e marrin edhe pensionin bazik. Prej Serbisë në Kosovë i marrin 32 mijë vetë pensione, shqiptarë e serbë. Pra njona prej pyetjeve osht a duhet këtë shtyllën e parë me lanë qeshtu a duhet më ndërru. E dyta osht pensionet kontributive, e kemi 15 vjetëshin që duhet m'i pasë përvojë pune para '99. Problemi është që disa thonë që nuk duhet me qenë 15 se s'ka qenë kështu kurrë, disa thonë po qashtu duhet. Po problem është ata që i kanë qit prej pune, a duhet me ia njoftë përvojën a s'duhet. P.sh. sektorit të arsimit tash i njihet përvoja e punës, po ata s'po janë të kënaqun po kërkojnë hala ma shumë. P.sh sektorit të shëndetësisë e sportit, nuk u njihet. Tash pyetja është a duhet me iu njoftë të gjithë sektorëve përvoja e punës a vec atyne që e kanë lobimin ma të fortë? Unë pres sot prej juve propozime konkrete.

Masnej e kemi pensionin familjar edhe atë të invaliditetit të punës që osht 75 euro. Është mirë që po zbatohet por nuk është i drejtë se p.sh ni njeri që punon me mbet invalid, i merr 75 euro pavarësisht se sa e ka pasë rrogën. Ma herët kjo ka qenë në proporcion me punën. Edhe pensioni familjar njëjtë. A mundemi me ndërru, a me lon kështu. Ma e keqja është në rastin kur mbetesh invalid me vetëm 80% paaftësi, shteti nuk të jep kurrgjo. Në anën tjetër, i kemi invalidët e luftës, të cilët 20% me qenë indvalidë, i marrin 220 euro.

[1] Transkriptet janë të redaktuara. Diskutimet që nuk janë relevante për temën janë hequr. Sidoqoftë, varësisht nga nevoja e hisedarëve, inçizimet e takimeve mund të kërkohen nga INDEP.

E kemi shtyllën e dytë – trustin – na të rinjtë po pagujmë në trust prej 2002, njerëzit që dalin tash në pension, maksimum marrin 40 muj, mas 40 mujve, kthehet në 75 euro. As kjo s'është e drejtë. Se sa do që i run, mas 100 mujve, i hargjon.

Edhe shtylla e trete- vullnetare, aty kush ka ma së shumti pare me lanë anash.

Dmth këto tema edhe të tjerat që nuk i hapa, pres prej juve propozime, që me mujtë na me i diskutu me grupin punues edhe me lobu për këto propozime. E hapi diskutimin!

Folësi 1:

Jom pensionist invalidor që 29 vjet. E përcjella me shumë vëmendje që i ceke disa gjana shumë interesante dhe të nevojshme. Në krejt botën, pensioni invalidor është i garantum. Unë kam shokë që iu vijnë pensionet prej Amerikës, pavarësisht prej moshës. Unë jom invalid prej 32 vjet, jom lëndu në vend të punës, sot jom invalid i kategorisë së parë, 100% i paaftë edhe atëherë kur kom dalë pension, njëjtë jam kanë. Qysh asht e mundun, unë e di që senet janë pshtjellë mas luftës edhe në cdo nivel osht bo njëjtë, po osht mirë ju që qito propozime tonat me i përcjell se edhe pensioni familjar edhe ai invalidor duhet me pasë parasysh shëndetin, moshën. Osht mirë që pensionet invalidore të jenë të barabartë me invalidët e tjerë, si më invalid të luftës. Se përndryshe nuk është e drejtë. Ta keni parasysh që gjendja nuk është në rregull. Numri i pensionistëve është rritë shumë pas luftës. Para lufte e kom marr bashkë me shtesa të fëmijëve, 700 marka për dy vjet. Pas luftës u ndryshun menihere senet, u ndërprenë pensionet invalidore, s'kom marr hic. E tash e marr. Unë po du me marrë qat që më takon, unë kam qenë kontributpagues deri në ditën e fundit edhe ma vonë jemi bo barabar me ata që s'kanë pagu. Tash ka shumë pak që kanë mbet invalid të punës. Me pensionin që e kom marrë para luftës, kom mujt m'i majt fmitë edhe krejt familjen edhe krejt shpenzimet. Po bile ni përqindje me pasë ma të madhe. Sa e merr kryeministri rrogën për 1 muj, unë duhna me prit 30 vjet.

Folësi 2:

Kom propozim që në nivel të Kosovës mu formu ni komision professional, special, që i njeh të gjitha sendet në mënyrën ma të sinqertën, ma moralën, ma të mirën, ma njerëzorën. Edhe qai komision krejt nevojat njerëzore m'i parapa edhe m'i kategorizu, se na kurrë s'mundemi me kry këtë punë. Vendimet prej këtij komisioni duhen me qenë normale dhe njerëzore, të barabartë për të gjithë njerëzit, pa hile. Nese s'formohet ky komision, na vec mujna me fol badihava. Ti fole edhe për këta që i marrin pensionet edhe këtu edhe jashtë. Po ku ka poshtërsi ma të madhe në botë. Kjo osht e pamoralshme.

Folësi 3:

E falenderoj organizatorin e takimit dhe të gjithë të pranishmit. Unë isha përqendru në tri pika që ndoshta për qit rend të ditës të reformës së sistemit pensional. Zhvilloj aktivitet që prej 2002, mendoj se edhe skemat e ndihmave sociale edhe skemat e ndihmes pensionale kërkojnë reformë, se na jemi lodhë me këto parametra që janë parapa atëherë. Mendoj që reforma duhet patjetër të bahet, por janë disa kritere që nashta ato vetem po përshkruhen prej atyne të mëparshmëve dhe po zbatohen në praktikë. Isha nal te shtylla e dytë – pensione kontribues – aty dy ditë para se m'u bo 15

vjet nuk ia kanë dhanë pensionin. Na kemi kërku si organizatë që 10 vjetëshi me kon në pyetje jo 15. Po edhe këta që për dy ditë si kanë bo 10 vjet, prapë është diskriminim.

E kemi pasë në komisionin, atëherë qeveria e ka marrë për obligim; 17 anëtarë kanë qenë ekspertë. Edhe vetëm dy here na ka raportu neve si sindikatë që ka zhvillu takime me qata njerëz dhe ka zhvillu aktivitete në Strasburg, kurre s'kemi pasë naj njoftim ma të thuktë prej këtij komisioni. Pensionistat kërkojmë reforma të thella. Kategorizimi nuk është në nivel. Na propozim konkret nuk kemi ba, po kemi ba që në bazë të përvojës së punës dhe kualifikimit me shku në katër kategori.

Folësi 5: katër kategori është.

Folësi 4: Edhe dicka që na brengos neve si organizatë për njerëz me nevoja të vecanta është që kur e marrin pensionin këta njerëz edhe invalidët e luftës dhe invalidët me nevoja të vecanta, edhe aty ka diskriminim se na kur aplikojna që i kena njerëzit në karroca; ata na refuzojnë.

Moderatori: Qysh i refuzojnë? Ata s'guxojnë m'i refuzu

Folësi 4: Djalin e kom rast konkret. Po aty na jemi të pakënaqun se i kemi njerëzit në karroca, po tash osht ligji i ri për tetra/paraplegjikë; e duhet me ekzistu ndihma edhe per kujdestaret e njerëzve me karroca. Ligji duhet me u aprovu pavarësisht a osht tetrapelgjikë a paraplegjikë se kanë nevojë për ndihmë. Edhe 1 cashtje. Une e pata ni brengë - une jetoj ne fshatin germove – e zhvilloj ni aktivitet temin edhe para 1 jave kuvendi komunal ka pru vendim që mu hek Baraka ku zhvilloj aktivitet humanitar. Te na politika po ndikon që pa kurrfarë projekti… u kon aty pronë publike ku unë kom investu. Na kanë cu në katin e tretë me majtë aktivitete.

Folësi 6:

Unë kisha pasë për reformë vec dy propozime: Stazhi 90 – 99 m'u pranu, bile na minatorët e kemi pas 12 muj beneficionin e stazhit, po edhe stazhi mas luftës, unë kom punu edhe 6 vjet mas lufte, më kanë qit në pension të parakohshëm, e atëherë unë jom met me 75 euro që 1 vit. Ma heret e kom marrë pensionin e Trepcës 135 euro, tash që kom dalë 65 vjet, e kom 75 euro. S'ma kanë llogaritë stazhin para lufte, se i kom do ndërprerje, po kështu i kom 13 vjet e gjysë pa beneficion edhe të burgut i kom 2 vjet, po s'ma kanë lëshu vendimin hala. S'po me del pensioni per me jetu. Propozimi jem osht me u pranu stazhi edhe beneficioni.

Folësi 4: Zotni, nuk numërohet beneficioni 90-99, unë kom beneficion edhe kom dëshmi. Unë e kom vendimin e serbëve që na kanë largu prej punës. Dmth duhet mu pranu stazhi i atyne që i kanë largu prej punës. Unë deri në 2004 kom punu.

Folësi 7:

Une vec dashta me shprehë ni përvojë. Kam qenë në punë në Lladost edhe '91 janë dëbu krejt punëtorët, contribute s'ka pas. 2002-2003 ka fillu trusti edhe punëtorët që kanë punu prej '91 deri sot nuk kanë pagu kontribute. Osht e padrejtë me ua njoftë arsimit se ata sadopak kanë marrë pare prej qeverisë së përkohshme. Tash këta punëtorë që janë suspend me '91, kanë met rrugvë, dinar s'kanë marrë kurrë dhe nuk e kanë përvojën e duhun për me marr pensione. Tash kthehemi te komuniteti serb; merr pension ne Serbi, merr ketu. Osht e padrejtë, pensionisti i shteteve tjera vjen edhe ketu i merr e ia jep dikujt te familjes. Mandej po lajmërohen do avokatë të rrejshëm kishe me

na nxjerrë pensionet ne Serbi, e s'duhet mu mashtru se Serbia pare nuk jep; pa u marrë vesh qeveritë. Unë kisha thanë 10 vjet me kanë në ven të 15 vjetshit.

Folësi 8:

Nuk është mirë me përcaktu 10 vjet, kjo është mirë prej 1 vjete. Me marrë aq sa ka punu. Nëse ka punu 20 vjet, e merr për 20 vjet. Qaq sa i takon, qaq le ta merr. Qiky ligj duhet mu ndërru, duhet me u ba ni reformë.

Folësi 9:

Mu e para e punës po më vije mirë që dikush po mirret me këtë segment të rëndësishëm të shoqërisë. Skemat pensionale duhet t'i shërbejë që secili të marrë aq sa kontribuar. Po këtu tek ne ndodhin gjëra paradoksale, ku kam dëgjuar se një pensionist i merr disa pensione nga Kosova, Maqedonia, Turqia e Kanadaja. Si? Unë këtë e kam me të dëgjuar. Ka punuar në kompani të Maqedonisë, ka migru në Kanadë, e ka ble stazhin në Turqi etj. Me aq sa di, prej këtij viti fillojnë të paguhen edhe pensionet invalidore dhe familjarët, cka është një e arrirë. Tash do t'i kthehem edhe segmentit arsimor se i takoj këtij sektori. Është e vërtetë që edhe unë kam pagu një 3%; ne nuk po luftojmë asgjë jashtë suazave, por po kërkojmë dicka mu realizu dhe e kemi pa si paradoksale që një mësues ka punu në mënyrë të vazhdueshme ndërkaq kur është plakë i ka taku vetëm pensioni i pleqërisë. Tash është rregullu disi, por për neve ka qenë paradoksale të na kërkohet dëshmia e punës në një system që na ka përjashtu nga sistemi i punës. Është çështje tjetër që punëtori arsimor merr nga disa burime pensione dhe kjo sigurisht me reforma se reforma qat qëllim e ka, të ndryshojë për të mirë. Reforma duhet t'i adresojë të gjitha problemet dhe mospërputhjet.

Folësi 9:

Ju jam falënderus juve, aq sa ju njoh juve, e di që duhemi me qenë falenderus ndaj juve. Po du m'i ra shkurt se u folë shumë. Unë jom punëtor i arsimit, 40 vjet kom punu, e nuk osht e drejtë që dikush që ka punu 15-16 vjet me marrë kontribut sa unë. Osht koha me u barazu, une jom punëtor i arsimit, mu nuk po më knaqin p.sh shokët e mi që kanë punu nëpër fabrika, nuk marrin; osht koha me u bo ni ligj, ni reform e mirëkuptim mes njerëzve. Osht e vertetë që në Jugosllavi unë kom punu në arsim, e ka pas namin e vet, po nuk do të thotë se dikush ka bo ma shume e dikush ma pak. Hajde të bohemi krejt të barabartë. Qysh thanë edhe ma herët, ai që ka punu 1 vjet, le ta merr për një vjet. Kur është puna të kategorizimi, unë kam propozu që akademikët me pasë pension ma të naltë. Unë kom kry fakultet, po s'kom mrri me botu libër. Tash akademiku, magjistri duhet me dallu së paku në kategori me 10 euro. Është pak pa njerëzore. Esat Stavileci i ka botu 28 libra, ai ka shku i ndjeri i barabartë me rrogën tem. E këtu po them, kujna t'i shkon fjala, ta bojmë ni harmonizim të jemi të gjithë të kënaqun. Unë për veti, po thonë 63 shtesë për mësuesit që kanë punu deri mbi 10 vjet; nashta e kom gabim; ata që kanë punu 5 vjet, 23 euro shtesë; mos të mirremi mes veti, jo arsimi s'ka punu, jo shëndetësia s'ka punu. Ta gjejmë ni gjuhë të përbashkët që të jemi krejt të kënaqur.

Folësi 10:

Pyetja osht për cilat vendime pranohen: p.sh dëftesat s'pranohet, vërtetimi për punë/vendimi, a pranohet?

Folësi 11:

Unë i takoj ni kategorie krejt tjetër; jom ish punëtor i policisë. Edhe ata që s'janë kthy në punë edhe ata që janë kthy; i takojnë ni kategorie. Osht mirë që ka fillu mu mendu për reforma në këtë lami. Po reforma osht shume e rendesisshme edhe duhet me i përmirësu padrejtësitë edhe gabimet që i ka ligji për skemat pensionale. Ky ligj osht diskriminues; tash sa kam të drejtë unë si individ me bo kësi konstatime, këto ma s'pari janë konstatime të organizatës ndërkombëtare ILO në Genevë, që e ka identifiku komplet cka ka ndodhë në Kosovë. Jon dy rekomandime të Avokatit të Popullit; institucion kredibil që ka thanë që ky ligj osht diskriminues. Cashtja tjetër: populli shqiptar ka përjetu çka s'ka përjetu kërkush. Në vitin '90, Kushtetuta e 2 korrikut e ka kriju një front të përbashkët ku i gjithë populli shqiptar ka qenë mbrapa asaj deklarate. Kjo ka cu që Serbia me i futë masat e jashtëzakonshme në Kosovë në mënyrë urgjente e ka nxjerrë ligjin e punës për veprim në masa të jashtëzakonshme – kanë fillu masat e dhunshme në të gjitha organizatat punuese dhe institucionet. Kështu s'ka ndodhë kërkah në botë, po ka qenë rëndësi uniteti i popullit, e ai s'kthehet kurrë ma. Pjesëtarë të ndryshëm të institucioneve e fushave të ndryshme nuk kanë pranu me i përballu masat e dhunshme. Kjo na ka bashku. Ky ligj osht diskriminues. Osht punu me hile. Thuhet këtu: ata që kanë punu në sistemin e Republikës së Kosovës kanë pagu – na kemi pagu deri në vitin 1990 në fondin pensional, atë e ka plaçkit Serbia, ato pare s'janë më në Kosovë. Ata që e kanë vazhdu punën në sistemin e Republikës së Serbisë në Kosovë, se di a kanë pagu; te na ato pare nuk janë se kanë pagu direkt në fondin e Republikës së Serbisë. Ata e marrin pensionin e plotë. Prej '90 – '99 kush e ka stazhin, e merr të plotë. Dmth u njihet edhe atyne që kanë ardh si koloni në '90 e mas '99 janë shpërngulë. Po flas për kategori të njerëzve, s'jom kundër që kanë punu shqiptarët. Tash ata kanë punu e pagu, po s'kanë pagu në Fondin pensional të Republikës së Kosovës se nuk ka ekzistu atëherë. Ata që kanë pagu në Fondin Pensional të Republikës së Serbisë, i marrin pensionet e plota. Ata që s'kanë pagu në atë fond, e kanë pensionin 75 euro edhe vazhdojnë m'i pagu tatimet e taksat.

Neni diskriminues - Neni 8. Na kemi me kërku që ky nen me u amandamentu edhe në mënyrë urgjente mu ndryshu edhe me thanë: Punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë, e aty ku shkrun "të tjerëve" me bo të gjithë punëtorëve të cilët dëshmojnë se janë largu në vitin 1990 prej punës me iu njoft stazhi. Ky start osht i nevojshëm me ua kthy dinjitetin. Varianti tjetër që e kemi mendu osht me hjek krejt – as 10 as 15 – pa kushtëzim. Po nuk e kemi caktu qysh tani.

Folësi 11:

E përshëndes INDEP-in për këtë organizim. Gjana konkrete: Duhet m'i nalë dy pensione. Vetëm pensionin e Kosovës me marrë; mu ngritë fondi i Kosovës. Se kjo u vazhdu po ka mbetë në gjysmë. Serbia nuk i jep dy pensione. Na s'jemi ekspertë të lamisë. Idetë janë të mira, po prapë. E kudo që përfaqësohet shoqnia civile e organizatat.

Folësi 12:

Për këtë temë në detaje nuk jam i përgatitur shumë. Po qysh e bisedum edhe ma herët, nuk kom arritë me pa kategorinë e personave që kanë kontribu shumë, jo pse unë jom kon pjesë e saj, po këtë e dinë të gjithë. Këshilli për Financimin e Kosovës, njerëzit që e kanë bajtë barrën kryesore për me pasuru qat fond që sot atë rol e lun ATK-ja, po në rrethana normale, e jo si atëherë. E aty kanë punu njerëzit që 8 vjet, po asnjoni nuk është në regjistrin e skemës pensionale. Tjetra, na duhemi me

ditë që këto ligje bahen për interesa të caktume, se osht ma lehtë me majtë nën kontrollë popullatën me kësi ligje diskriminuese duke i favorizu të mdhajt e tu i shkelë të vegjlit. E jetëgjatësia e qeverive osht shume e madhe, njëjtë qysh osht tu ndodhë tash me ligjin për paga të shërbyesve civilë. Unë jom në kontakt me ministrin vazhdimisht, edhe presionet janë qaq t'mdhaja sa që mu dashtë m'i thanë ministrit, kom me të paditë në gjykatën ndërkombëtare nëse ti ki me ndryshu dicka prej këtij ligji. Nuk dojnë me i barazu njerëzit. Zyrtarët e shtetit duhet të paguhen në bazë të përgatitjes profesionale, përvojës dhe pozitës. Ndodh kaniherë që vendi i punës osht për shkollë të mesme, po njeri i papunë ka konkurru për qat pozitë me fakultet. Tash ai e ka problem se vendi i punës e përcakton nivelin e pagës. Duhet me fillu me i barazu kategoritë e shërbyesve publikë, për faktin se po krijohen qasi diskrepanca sa që unë e shoh që të shërbyesit civilë ka ra vullneti me majt shtetin, e shtetin e majnë zyrtarët. Ka pasë diskutime për reduktimin e numrit të njerëzve që marrin asistencë sociale, une këtë ide e kam pasë moti. Ata që kanë qenë të aftë për punë, unë si kam leju me marr asistencë sociale prej shtyllës së dytë, varësisht se ligji ia garanton. Unë i kam thirrë kompanitë që kanë pasë nevojë për punëtorë edhe u kam tregu atyne për vendet e punës. Osht e vetmi rajon Gjilani që janë vetëm 14% shfrytëzues të asistencës sociale në shtyllën e dytë. Tjerët e kanë krejt mbi 50% se jena mësu paren e shtetit me qujtë paren e dërzhavës, dmth e huja. Të lutem e përfshini në skemën pensionale edhe KFK-në se ka njerëz që e kanë pagu edhe me shpinë atë pare që e kanë mledh. Ilmi Pograxha u rreh e u majtë në shok sobë vec pse ia kanë gjet bllokun me Republikën e Kosovës. Kjo kategori që u ka dhanë pare edhe msusve, e msusit nuk po e permenin e s'po jua zo për t'mirë. Pa funksionu Këshilli i Financimit asni pare s'kishin mujt me marrë.

Folësi 13:

Jam kryetar i ni organizate për zhvillimin e bujqësisë. Jam arsimtar i gjuhës shqipe. Edhe shpesh më kanë thanë si arsimtar cka po merresh me këto punë. Po na e kemi majtë shtetin ma herët, e kom dasht me iu nimu njerëzve me këtë shoqatë. E pash që në ni gazetë shkruake për mu "në krah të të mdhajve", se une i kom kritiku. Po unë kom qejf me kontribu, pa e marrë asni cent. E sa i përket shtyllës së dytë edhe pensionit bazik, unë e kom ni pytje per krejt. Kur dalim në pension, a jemi pensionera a jemi profesora e doktora. Unë menoj që në pensionin bazik duhet me kon krejt ata që janë pa punë. Që s'kanë punu po janë 65 vjet. Unë po du që krejt punëtorët me pasë ni rrogë të nivelizume pavarësisht profesionit dhe pagave që i kanë marrë. Ai që i ka 15 vjet përvojë e ma shumë, me marr pensionin e njëjtë si këta me të njëjtën a ma shumë përvojë pune. E këta tjerët, qaq sa ka rujt secili.

Folësi 14:

Këtu u celen tema të ndryshme, po në fakt jeta ka tema të ndryshme në jetë. Ma s'pari e kemi ish-sistemin, tani i kemi skemat pensionale. Ma herët këto s'jon kon skema, po të drejta themelore. Krejt qëllimi i kësaj reforme osht me u kriju ni siguri sociale për në pleqni. Se vec pensioni qysh e kom lexu sipas definicionit osht siguri për pleqëri ose invaliditet. Dmth edhe pa u plakë munesh me marr pension. P.sh, këtij që ka mbet invalid atëhere, pensioni iu ka caktu prej nivelit të pagës edhe përvojës së punës. Pensioni invalidor osht marrë njëjtë për atë që u lëndu mas 1 dite a 2 vjete, njëjtë si ai mas 40 vjete. Ky sistem osht i pranum në krejt botën edhe u bo prej organizatës ILO në bashkëpunim me njo tjetër. E tash te përvoja e punës. Edhe ILO e pranon 15 vjetshin, ama e kanë parasysh që në vendet ku ka krizë e luftra, kjo përvojë zbritet. Si në rastin e Kosovës. Tash cka duhet

mu bo këtu. Janë dy parime bazë: parimi i barazisë para ligjit edhe parimi i proporcionalitetit. PP – në bazë të kohës, p.sh nëse dikush i ka 15 vjet, po ni muj ma pak – 15 vjet janë 180 muj, nëse nuk dojnë me shku me vjet, mujn me shku me muj. Tash mujna me zbritë edhe në 10, po cka me bo për këta pa 1 javë 10 vjet. Mujna me zbrit prej 2-5 vjet edhe me ua jap menihere si rentë. Unë menoj që duhet me u zbrit deri në 1 vjet, nëse s'ia japim në baza mujore, me ia jap përniher.

Kategorizimet e ndryshme – E di që i kemi bo disa gabime.

Skema për kategoritë e veçanta – këto ligje e kanë emrin kompensim monetar për të verbrit p.sh. Dikush pyeti pse po refuzohen njerëzit në karrocë. Po refuzohen se doktori thotë që ky nuk e ka diagnozën tetraplegji a paraplegji, por ka diagnozë tjetër që e përfshin krejt trupin. E ligji osht i poshtër se thotë vec tetra/paraplegjikë. Në reformë duhet me u shti edhe përcjellësit/kujdestarët. Stazhi '99 – Menoj që krejtve duhet me iu pranu stazhi që janë largu prej punës. Në ditë të sotit njerëzit po jetojnë ma gjatë, e reforma po kërkon nëpër botë që njerëzit me punu ma shumë e me rrnu ma pak. Ata po i zvogëlojnë krejt venet e punës që kanë definicione. E sa për me dëshmu përvojën e punës; Mu më mjafton vec dokumenti që e vërteton punën, s'më intereson kontributin. Unë menoj se si ligji i arsimit, si i FSK-së, janë ligje që dojnë me privilegju ni kategori.

Fondi pensional me u kriju osht shume problem. Munet me kon fond privat po ekspertat thojnë se ky fond me krejt merret vec me varfërinë jo. Reforma sociale duhet mu marrë edhe më varfërinë. Na duhet me bo ni ligj unik që i harmonizon krejt kategoritë.

Fokus Grupi II

Mitrovica

Folësi 1:

Unë kam qenë edhe në tryezën që e keni organizu në Sirius, disa prej këtyre kanë qenë, disa jo; po ju i keni paraqit mirë krejt skemat qysh jon e qysh duhen me kon. Unë e kom lexu edhe punimin e juj edhe më ka pëlqy shumë. Ju i shtrut edhe sot disa tema. P.sh. pensioni bazë që ka ekzistu gjithë. Pensioni kontributiv nuk mundet me qenë i njëjtë për të gjithë se krejt kontribuojnë në shuma të ndryshme. Pensioni i pleqnisë le të mbetet kështu sic asht. Kurse largimi nga puna i krejt neve që me ardhë në pushtet këta; e i lamë fëmijtë pa bukë, e sot kta neve po na lajnë pa bukë. Unë po kërkoj që me mu njofto si stazh pune periudha kur më kanë largu prej punës gjatë viteve '90 që me mujtë me realizu ni të drejtë temen. Kurse, gjatë periudhës së okupimit serb, cdo individ, qoftë tuj marrë frymë, a që s'ka pasë me pi; ai e ka dhanë kontributin e vet për qit ditë që jemi sot. E sot kërkoj që qeveria me na trajtu dinjitetshëm. Sa i përket trustit, trusti osht tu na plackitë. 6 mijë euro e ka rrogën kryetari i trustit e kontributi jem 2-4 mijë që i kom, sa herë nxjerri pare prej bankomatit ai më plackitë. 60 euro në vjet. Dikush po më plackitë mu. Edhe po du mu kriju Fondi Pensional, ato që kom kontribu unë, m'i marr dikush edhe kështu gjeneratë mas gjenerate. Edhe skema pensionale edhe sigurimi social të jenë të dinjitetshme.

Folësi 2:

Problemi tash asht që krejt mjetet i ka qitë në bankë trusti, edhe me dasht me ndrru llogarinë s'mundesh.

Folësi 3:

Unë e kom pensionin 75 euro me 34 vite pune, i largum prej marrëdhënies së punës me 20 gusht 1990. Jo me qejf. Dhe nga 28 marsi 1992 kur ka fillu mu financi arsimi, osht themelu Këshilli Komunal për Financim edhe jom kon kryetar deri në 99. E qajo përvojë 9 vjecare, neve këshillave të financimit nuk po na njihet si përvojë me skemat pensionale. Në nenin 8, pika 6, ku thotë edhe të tjerët... kush janë ata tjerët? Ata e kanë lanë me qëllim të caktum që mos me realizu kërkush. Unë e kom marrë vërtetimin që jom kon kryetar i këshillit për financim; i kemi dërgu nëpër shërbime përkatëse - Ministria për Mirëqenie sociale na i ka refuzu se nuk i kemi 15 vjet, nuk na i njohin ato vërtetime të drejtorive komunale për përvojën tonë edhe për cudi vendimi për refuzim nuk ka autor specifik. Duhet mu njoftë përvoja; unë i kam 9 vjet përvojë pune, na kemi bo padi, po s'kemi marrë përgjigje prej gjykatës. Unë në '79 jom punësu; s'kom mujt m'i pasë 15 vjet përvojë pune. Edhe pse kemi insistu me na u njofto përvoja e punës, unë bashkë me tjerët grupe, na kanë thanë që do t'ju njihet. Jemi viktima me gjithe atë sakrificë që e kemi bo. Pse nuk po zbatohet kjo dispozita "dhe të tjerët".

Ky 15 vitshi gradualisht vec po zhduket. Ju e përmendët në diskutim 15 vjet para 2002-tës, kjo se ndihmon atë pjesë që janë largu në vitet 90. Vlerësimi për cdo vit osht primare, nëse unë kom punu 5 vjet, le t'më numërohet pensioni për 5 vjet. Kërkush s'munet m'u anku që pse ai paguhet ma shumë se ka përvojë pune ma shume. Duhet m'u pajtu me këtë.

Folësi 4:

U folë për invalidë të punës. Mu dokë që u përmend që invalidi i punës para luftës me u pagu 75 euro pension. Ky është ligj qesharak. Invalidi i punës duhet me u pagu ndryshe prej pensionistit. Pajtohna që duhet m'u pagu pensioni në bazë të përvojës së punës; qaq sa ki punu. A osht pensioni jem i garantum? E tash ekziston ni shqetësim. Qata që e kanë të garantum edhe iu ka vra djali, osht familje e dëshmorëve; atij ia kanë nal pensionin e pleqërisë. Duhet me i bashku dy pensionet. Duhet mu ndryshu ky ligj. Invalidi edhe dëshmori duhet me i marrë dy pensione. Me iu bashku. Secili le t'i merr qysh t'i takojnë.

Folësi 5:

Mendoj që këtu ekziston ni laramani. Deri vonë ka pasë ni person që i ka pasë dy të vramë, i ka marrë paret për të dytë plus pensionin e vet. Sipas meje nuk osht në rregull. Propozimi jem osht që pensionin e vet le ta merr, po këto që e ka pasë dikon të vram, le ta merr një përqindje të caktume. Mos le t'i merr 2-3 pensione, po pensionin bazë edhe ni përqindje varësisht kategorisë.

Folësi 6:

Kish qenë mirë me u zbatu ky propozimi për pensione për dëshmorë. P.sh nëse e ki një të vramë në luftë, i merr 100. Nëse i ke dy, i merr 150 për dy. Pensioni merret ose prej prindërve, ose prej bashkëshortes, ose prej fëmiut deri sa t'i bon 18 vjet. Kjo duhet me u kornizu me ligj sic duhet e jo me qenë aq shumë i ndryshueshëm. Unë marr pension se kom punu, tjetri pse i ka vdekë dikush në luftë. S'bon me hupë gjaku i kërkujt.

Folësi 7:

Unë kisha dashtë me cekë pensionin për Trepcën. Ka njerëz që kanë punu 13 – 14 vjet, po për 24 orë i ka hup e drejta për pension. Unë propozoj që mu bo prej 10 vjet. Propozimi jem i dytë osht që këta që e kanë pas rrogën ma të madhe edhe kanë kontribu ma shumë, duhen me marrë pension në bazë të kontributeve, jo në bazë të kualifikimit arsimor. A është e lehtë për t'u realizu kjo?

Folësi 8:

Unë kisha propozu – se na jemi të moshum edhe e dimë krejt qysh ka qenë përpara – sigurimi i pensionistëve, p.sh me shku në banjë, në deti. Shteti m'u kujdes për pensionistët.

Folësi 9:

Unë kam punu në kompani sllovene në Gjermani, po kontributet i kemi marrë në Sllloveni. Unë kom punu në Sllloveni 14 vjet. Unë marrë dicka hala. Po unë jam edhe veteran i luftës tash. E tre muj e kom marr 158 euro, kur u kon 170 euro. Po unë s'marrë kurrgjë prej Sllovenisë. A bon tash mos me pasë nevoje me hjek dorë prej ni pensioni, po mu kombinu diqysh? Mandej edhe përvoja e punës në Serbi.

Folësi 10:

Unë kisha propozu Qeveria mu anagazhu që mu formu komisioni se shumica e pensionerëve e kanë fondin në Serbi. Fondi i pensionerëve osht në Serbi. Le të kthehet pensioni i pensionerëve që e ka marrë Serbia.

Folësi 11:

Unë mendoj që gabimin ma të madh po e bojna që po i qujna pensionistë. Pensioni bazë nuk është pension; ajo osht ni ndihmë e pleqërisë, ndihmë sociale. Pensioner munden mu qujt vec ata që jon t'u i marrë pensionet e Serbisë. Pensioni duhet m'u caktu në bazë të kontributit. Pavarësisht sa ka përvojë pune, të bihet ligji qysh osht në rajon, në Evropë. Propozim im osht me iu ndrru emri edhe me u caktu përmes kontributeve. Pensioni invalidor, familjar me u njoftë. Kom pasë rast që më ka ardh polici që ka punu ton jetën e i merr 75 euro pension.

Folësi 12:

Unë jom ekonomist i diplomum. Po shihet që i keni shoshitë këto punë. Sot jemi tu folë për reformën e sistemit pensional, dmth dicka që duhet mu ndrru se ajo që ekziston nuk asht në rregull. Sistemi pensional pa ligj pensional edhe pa fond pensional nuk ka bazë sipas menimit tem. Pa fond nuk ka pension. Sa e di, pensionet tash jepen prej buxhetit, e nuk e di a ka në botë kësi praktike. Fondi duhet mu kriju, e duhet me u kriju ligji që e përcakton rrogën mesatare të shtetit e tani me caktu pensionin mesatar. Kërkesa ime bazike osht fondi pensional. |E qysh formohet, osht procedura. Në fund, punon gjenerata me gjeneratë.

FL 10:

A nuk ndërhyn trusti me fondin tani?

Folësi 12:

Mos më ndërhyj, unë e kam fjalën. Nëse e bajmë fondin, trusti duhet me hi në fond. D.m.th me hjek trustin. Pensioni i dyfishtë, unë sa e di, në botë nuk ekziston. Osht gjynah me i marrë të dyjat. Serbët i marrin të dyja pensionet, shqiptarët e marrin vec 1 pension. Strazburgu ka thon ti e merr vec 1 pension, cka po don ma shumë. Po më doket që pe përzijmë pak se për veteranë, invalidë të luftës, janë ligje tjera që i rregullojnë këto punë. Nuk duhet me i përzi ato. Unë jom shumë kundër 15 vjetshit, edhe për ata që për 1 dite e hupin kto edhe për ata që kanë punu 40 vjet e e marrin pensionin e njëjtë si ata që kanë punu 15 vjet. Duhet me u njoftë për sa vjet ka punu. Invaliditeti duhet m'u pagu në shkallë të invaliditetit, dmth njëjtë krejt invalidët. Trusti me punu gjenerata për gjeneratë. Qashtu u kon gjithë. Fondi duhet me përfshi mallrat luksoze, si duhani e këto.

Folësi 13:

Po më doket që na krejt problemin po e dimë, e ju po e dini ma mirë se krejt na. Në fund lypet qypi me pare, dmth aq sa ka pare. Unë kam qenë pjesëmarrës i grevës, dmth i largum prej punës në vitet e 80 nga arsimi. Mu niher më kanë vra ata të regjimit tash politika. Osht gjynah me pagu luftëtarin. Kontributin tem të luftës ma ka kthy në pare. Mu ma ka hup ndjenjën tem kombëtare. Jo që kom bo najsen të madhe, po qe 14 muj jom kon maleve të Drenicës. E tash të rinjt mujnë me thonë, ty të kanë pagu. Partitë në pushtet e kanë prish këtë të veteranëve. Edhe që thatë që s'ka praktikë që m'i pasë dy marrje. Ka pasë. Baba i jem i ka marrë dy; po iu ka shtu njona. E nëse u kon ligj i mirë, le të implementohet prapë. E di që ministria osht tu e përafru praktikën që me i marr edhe ni shtesë krahas pensionit bazë për invaliditet p.sh. Unë jom kon pjesë e greves së 2004, ku kemi lypë ligj për pensione.

Unë kom dalë në pension mas 10 vjet pune për shkak të invaliditetit. Qysh munet me përmbush kuotën për stazh ni polic që del në pension mas 6 mujve të punës se lëndohet në punë.

Folësi 14:

Unë ia kom nisë mu marrë me këtë cështje që 1 vjet e gjysë, jo ma shumë. Unë i kom do shqetësime të mia personale; kom udhëtu e kom jetu jashtë vendit. Pikë s'pari, problemi osht te fondi që mungon. Jemi shteti i vetëm që pagujmë pensione prej buxhetit. Se kjo e falimenton shtetin; shpërdorimi i buxhetit e i rezervave shtetërore.

Pensioni bazik – ligji aktual osht diskriminues në baza fetare e etnike. p.sh veriu i Mitrovicës, unë kur i kom vizitu, nuk kom guxu. E kom vizitu Zubin Potokun, jon çudite krejt, ajo zyrtarja më ka prezantu si drejtor, krejt jon nalë tu m'kqyrë, a osht ky i cmendun që ka ardh ky? E në fakt i kemi 7 mijë pensionera në veri. Reforma duhet me kon në harmoni me të drejtat e njeriut. E dyta, kemi fillu me ARC-në, lajmërimin e personave të vdekur. Kjo funksionon ama prapë kemi probleme. Se ka që e kanë marrë edhe pas vdekjes pensione. Në zyret e Leposaviqit, leshohet certifikatë, ekstrakt i lindjes, pa kurrfarë kriteri. Unë se di qysh me zgjedhë kta. Unë po propozoj me thirrë edhe ekspertë, edhe zyrtarë të ministrisë të punëve të brendshme. Se në vende tjera osht vështirë me marrë letërnjoftimin, e te na ma së lehti. Pse ata të Serbisë mujnë m'i marr dy pensione, e shqiptarët jo.

Te pensioni kontributiv – unë e kom babën që e ka lëshu me zor Kosovën para 20 vjete edhe ka shku në Itali, tash u ballafaqu me përgaditjen e dokumenteve për Itali; atje ia njohin vec vitet, jo kontributet jo.

Të merret për bazë kualifikimi, vitet e të harmonizohet ligji.

Te pensioni familjar duhet me u specifiku kush e trashëgon pensionin. Se ka pasë rast që kur djali osht student, e nana punon; s'ia kanë dhanë pensionin. Duhet me i taku djalit, e në ligj so e specifikime a osht m'i taku fmisë pensioni.

Folësi 15:

Prej kësaj cka dëgjova, i kom do pyetje: Sa njerëz marrin prej Serbisë pensione? Me cfarë mekanizmi mujmë me i identifiku personat që marrin pensione prej dy anëve që mos m'i marrë të Kosovës?

Fokus Grupi III

Prishtina

Folësi 1:

Unë isha edhe atëherë kur INDEP-i e bani tryezën në Sirius. Mjaft bisedum atë ditë në lidhje me këto, andaj mos të përsëritemi. 1 tetori osht dita ndërkombëtare e të moshuarve, andaj duhet me u përgatit. Unë së pari kisha me u lidh me pagat që tha, pagat e arsimtarëve – mirëpo shtëpitë shkolla kanë mujt me ekzistu edhe gjatë luftës. Pastaj në mjekësi – mjekësia private gjatë viteve '90 – mirëpo shtëpi – Trepçë nuk mujtëm me ba. Prandaj të flasim vetëm për arsim, se mu po më duket që shumë po ngushtoheni në atë, e të mos flasim edhe për gjanat tjera që kanë ndodh në vitet e '90. 47 vjet punova, 4 vjet e gjysë nejta në shtëpi që më largun nga puna, mandej jemi kthy në punë pas luftës. Kështu që osht e vërtetë që kemi punu, po kemi punu edhe pa paga, e pensionet nuk janë dhanë. Pajtohem që ta marrim edhe deri në vitin 2002 e jo vetëm '90. Mendoj që ligji për pensione duhet të aprovohet gjithsesi. Unë e kam formu Forumin e Gruas Pensioniste.

Folësi 2:

Mendoj që propozime ka të bollta për përmirësimin e politikave sociale, po me rëndësi osht me ditë sa është vullneti politik. Se na i kemi që 19 vjet këta njerëz, po cka ka ndodh, mundemi me pa vet. Shikojeni perspektivën 19 vjecare të politikave sociale që i ka udhëheq shteti i Kosovës. (Flet keq per pushtetin, jo relevante për temën). Kur Ligji per Skema Pensionale u miratu, eshte pranu stazhi i njerëzve që kanë ardh prej (Klini?), serbo-malazezë, e u është pranu stazhi 10 vjet, në atë kohë kur ligjet janë suprimu e Kosova ka qenë e aneksume prej Serbisë e ata i kanë kry funksionet e shtetit. Ata persona tash qysh me i hjekë prej skemës pensionale. Me këtë ligj legjitimohet periudha 90 – 99 si periudhë normale. Kqyrni rekomandimet e ILO-s kur permendet debimi i punetoreve shqiptarë në baza e me motive politike. Na i jemi drejtu Avokatit të Popullit, i cili e ka nxjerrë rekomandimin që thotë që punëtorët e -90 nuk janë fajtorë pse janë largu prej punës dhe kërkon me u njoftë stazhi i punës. Rekomandimi u është dërgu ministrisë adekuate. Ligji për pensione e për skema sociale, janë shumë diskriminuese.

1) 15 vjetshi nuk bon. Duhet me bo minimum 5 vjet. Qaq sa vjet i ki kontribut, qaq paguhet edhe pensioni.

2) Stazhi i punës së viteve ’90. Duhet me rregullu gjithsesi dhe me u njoftë. Nuk duhet me qenë deri në ’99, ose duhet me qenë deri në periudhën kur u suprimu pavarësia e Kosovës ose deri në 2002 kur kanë fillu pensionet.

Folësi 3:

Unë për momentin e shoh diskriminues ligjin për stazhin e punës dhe propozoj që ky stazh i punës të periodizohet në 5 – 10. Ka njeri që se merr për 5 – 10 ditë pensionin. Që so në rregull. Kjo osht për mu diskriminuese. Kjo zgjidhet me perioda, p.sh 5 – 10 deri në 15.

Diskriminuese osht edhe pranimi i diplomave. Thotë p.sh vec nëse e ke kry në vitin ’91. Fakulteti duhet me iu njoftë njerit gjithë. Unë kam punu me shkollë të lartë pedagogjike në BQK edhe kom marrë rrogë si me fakultet se ma herët nëse e ke pas shkollën e lartë e ke marrë si me fakultet, me ligj. Ose tjetri ka punu me fakultet, po pozita e punës u kon me shkollë të mesme. Që so në rregull, pse mos me iu njoftë fakulteti. Kurdo që e ka kry. Data ’91 me u hjek, me u njoftë kur e ka kry.

Ndihmat sociale, patjetër duhet me u ndryshu. Kemi raste plot. P.sh thotë ndihmë sociale merr personi që ka fmi deri në 5 vjet. Njo prej kritereve. Pse mos me shku deri në 18 vjet. Deri sa osht në shkollë. Te na s’ka shtesa. Ligji mbi ndihmat sociale i cili parasheh që fmia me qenë deri në moshën 5 vjecare të ngritet deri në moshën 18 vjecare.

Absurd osht kur u rriten pagat krejtve prej ministrit e vec pensionerëve jo. Se unë i kom shërby këtij populli 47 vjet. Se unë kom kontribu shumë. Në Kosovë jon pronësu dy sene si kadastër: pushteti edhe lufta. Unë kom bo ma shumë luftë se sa me pasë marrë pushkën. Pushteti duhet me ndërru mendësinë.

Folësi 4:

Na ishim kanë budallë që prapë se prapë ia japim votën të njëjtit. Unë kom punu 20 vjet në shkollë, mandej deputete, e pjesë e forumit të grus. Unë 2 vjet e kom marr kah 65 euro pensionin mandej ma kanë ndalë, e mandej u bo 150. Cka mujmë me bo për zyret e pensionistëve që na kanë lon pikë e pesë? A mundesh ti me bo najsen, se na kanë lon në Baraka.

Folësi 5:

Me folë për pensionistët dina krejt. Jemi kategoria e lanën krejtësisht pas dore, edhe institucionet tona na njofin vec gjatë zgjedhjeve. Kryhen zgjedhjet edhe mo nuk nihen. Na kemi majtë një kuvend të pensionistëve ku u kon edhe ministry, e i kemi shprehë edhe mendimet e kërkesat tona, po përgjigje s’kena marrë. Kish me qenë që në takimin e fundit me marrë pjesë edhe ministry edhe mu njoftu me kërkesat tona. Mu më pëlqyn shumë propozimet tuaja. Edhe ministria duhet me i përfshi këto. Ligji duhet me u ndryshu, e duhet me u miratu edhe ligji për pensione invalidore e sigurime shëndetësore që pensionisti me i gëzu të drejtat themelore. Kategorizimi që u bo, nuk osht i mjaftueshëm se janë lanë shumë sene jashtë; si stazhi e këto tjera.

Folësi 6:

Pensioni ma i ultë osht 200 euro. Osht mirë m'u bo ni lloj korrigjimi. Edhe ajo '90, m'u shty deri në 2002 se krejt e dimë që kërkush s'ka dal prej punës për qejf të vetin. Edhe mos të mirren parasysh vec disa kategori, si arsimi e shëndetësia. Se këto sektore lehtë mujnë me blloku krejt funksionimin e shtetit. Osht mirë mos mu bo dallime të tilla.

Folësi 7:

Krejt cka u folën, mos t'i përsëris; i përkrahi. Vec ka hala ma shumë për m'u cekë edhe për t'u punu, po jo vec fjalë. Na duhemi me marrë hapa ma radikale. Duhet me tregu a dojnë me na i plotësu kushtet, nëse jo, me dalë në grevë. Ku osht trusti për pension që u kon deri në '99 – grabitja e trustit në Serbi. Mesatarja osht 180 euro e pensionit. E tash vendet e Ballkanit e kanë pasë rreth 580 euro. Na jena met me pensionin ma të ultë. Po kërkesat tona kanë hasë në vesh të shurdhët. Na duhet me kërku me u plotësu kërkesat tona edhe me mënyra tona.

Folësi 8:

Pushtetarët po e krijojnë situatën që qytetarët me dalë në protesta. Se po bojnë diferencime.

Folësi 9:

Me ni mbledhje kur jemi kon me ministrin, na kanë dhonë premtim që ka me pasë ndryshime në ligj. Na kemi dështu si shoqni.

Duhet me punu që mos mu trajtu kategoritë e pensionistëve ndryshe. Duhet me qenë uniform. Unë jom taku me tri komisione parlamentare; edhe me ministrin. Ai e ka pranu që ligji diskriminon dhe që o tu bo ni ndryshim. Edhe deputetët u pajtun që ligji osht diskriminues masi ua shpalosëm na krejt dokumentet e ILO-s etj. E njoni tha aty, ni deputet i NISME-s, që s'ka vullnet politik me ndryshu, e që duhet me ua thon truq kto pensionistëve. Na jemi të interesum që me i eleminu dispozitat diskriminuese.

Folësi 10:

Vërejtja ime e parë osht që na nuk bashkëpunojmë mes veti. Ne i kemi kërku prej fillimit – 2002 – po s'ka pasë mirëkuptim, e pushtetarët janë të interesum na mos me qenë të bashkum. Unë ju kom thanë krejtve të gjithë kërkesat tona jon te njëjtë, andaj pse te kemi ndarje. Ky ligji diskriminues, na e kemi përcjell edhe gjatë hartimit edhe kemi thanë që osht ligj diskriminues. Ditën e miratimit të ligjit, kemi bo protesta. Na thirrshim me dalë në protest, Lidhja thojke mos u bashkoni me sindikalistët. Njëjtë ndodhke edhe me peticione. Na duhet me bashkëpunu, e kërkesat me i pasë unike. Se kur janë unike, krejt i dëgjojnë.

Nuk ka cështje sociale ma diskriminuese se në Kosovë. Prej luftës deri sot, sen su bo në zgjidhjen e cashtjeve sociale. Krejt institucionet tona që i kemi krejt marrin shembull prej Serbisë, e sen s'kisha marr shembull prej tyne.

Vendimet e Strasburgut – Gjyqi kushtetues i Serbisë thotë që kosovarët duhet me i marrë pensionet, njëjtë avokati i popullit në serbi ka thanë që kosovarët që i kanë vendimet duhen me i marrë pensionet. Strasburgu ka pru vendim të premë. E pushtetarët tonë thonë që jon rekomandime e jo

vendime obligative. E në vendimin që e kom unë, nuk thotë që janë rekomandime. Aty thotë që vlen për krejt pensionistat e Kosovës.

Lidhur me propozimin e OJQ-ve, e kanë marrë ni iniciativë për cdo lavdatë. Këta e kanë pa që po vjen gjenerata e tyne që do të jenë pa pension.

Neni 8, pika 6. duhet mu hjek përniher, në mënyrë urgjente. Duhet me u pranu stazhi i punës i atynë që janë dëbu prej punës prej regjimit serb, e jo me iu njoftë atyne që i ka pru Serbia. Le të bahet me 10 me mujt me marrë pensionin.

Unë propozoj stazhi i punës – le të bohet reforma qysh e ka Evropa se qanej e kemi rrugën drejt BE-së. Të pranohet stazhi prej 5 viteve e ma tutje. Perëndimi e ka me përqindje për sa vjet punojnë. Absurdi që u kon osht që asni familjar nuk ka marrë pension familjar, a naj shtesë, për vdekjen e ni familjari.

E pervec vendimeve të Serbisë, qohet Edita Tahiri thotë duhet me hi në bisedime politike. Qysh munet me hi në bisedime politika shpia jem, a ligji për pensione.

Folësi 8:

Dikush e ka stazhin e punës, po nuk e ka moshën. Atij duhet me ia pagu ni shtesë me ni emër tjetër.

Folësi 10:

Na qysh e kemi analizu; domi i madh që po u shkaktohet pensionistave. Zakonisht pensionistat janë pa kualifikimee etj. E tash problemi osht që pensionistat po trajtohen pa shkollë për arsye se përkundër që si ka 15 vite stazh, e ka fakultet. Ai shkon në kategorinë e pensionistave që s'kanë kurrfarë kualifikimi. Nuk o problemi i pareve, po denigrimi i integritetit e i personalitetit. E ligji thotë që kjo duhet m'u respektu. Dmth duhet me u njoftë edhe kualifikimi dhe kategorizimi i pensionistave në bazë të kualifikimit. Dmth pensioni i pleqërisë duhet me njoftë kualifikimin. Se kur jipet ky pension i fut krejt pensionistat në një thes. Dmth për ata që nuk u njihet stazhi. E ata trajtohen si gratë që se kanë asni ditë shkollë. Nëse merret statistika e pensionistëve të Kosovës e vendeve tjera, del që krejt pensionistat janë analfabetë në Kosovë. Dmth e ngaterron pensionin bazë me atë të kontributeve.

Folësi 4:

Duhet me definu këtë çashtje. Dmth atyne që u njihet stazhi 15 vjet, atij duhet me iu njoftë kualifikimi edhe nëse e ka kry fakultetin mas '91.

Fokus Grupi IV

Prizren

Moderatori:

Na jemi të interesum me marr mendimin e propozimet e juja dhe po shkojmë në regjione. Krejt po thojnë që reforma s'osht mirë, tash po dojna me ditë cka saktë me ndrru. E po dojmë me bo ni përmbledhje të propozimeve e me ia dërgu ministrisë, edhe vet me bo ni punim në mënyrë që ministria nashta i merr parasysh nëse ka lobim të duhun. Ideja osht me bisedu cka mu ndërru.

Tash e dimë që gjeneratat e vjetra e kanë kryesisht problemin me sistemin e vjetër që ka të bëjë me njohjen e përvojës së punës para luftës, mirëpo ideja osht mu ndërru krejt sistemi e jo vec disa aspekte. Ma s'pari janë pajtu ministria që sistemi duhet me u ndrru krejt, tash po kqyrin cka mu ndrru. Ma s'pari osht pensioni bazik, na e dimë që pensionin bazik prej 75 euro e marrin krejt që i kanë mbi 65 vjet, po prapë nuk e marrin krejt, se ata që marrin pensione prej 20 skemave të tjera pensionale, nuk kanë të drejtë me marrë pensionin bazik, po ata që marrin pensioneve prej shteteve tjera, e marrin edhe pensionin bazik. Prej Serbisë në Kosovë i marrin 32 mijë vetë pensione, shqiptarë e serbë. Pra njona prej pyetjeve osht a duhet këtë shtyllën e parë me lanë qeshtu a duhet më ndërru. E dyta osht pensionet kontributive, e kemi 15 vjetëshin që duhet m'i pasë përvojë pune para '99. Problemi është që disa thonë që nuk duhet me qenë 15 se s'ka qenë kështu kurrë, disa thonë po qashtu duhet. Po problem është ata që i kanë qit prej pune, a duhet me ia njoftë përvojën a s'duhet. P.sh. sektorit të arsimit tash i njihet përvoja e punës, po ata s'po janë të kënaqun po kërkojnë hala ma shumë. P.sh sektorit të shëndetësisë e sportit, nuk u njihet. Tash pyetja është a duhet me iu njoftë të gjithë sektorëve përvoja e punës a vec atyne që e kanë lobimin ma të fortë? Unë pres sot prej juve propozime konkrete.

Masnej e kemi pensionin familjar edhe atë të invaliditetit të punës që osht 75 euro. Është mirë që po zbatohet por nuk është i drejtë se p.sh ni njeri që punon me mbet invalid, i merr 75 euro pavarësisht se sa e ka pasë rrogën. Ma herët kjo ka qenë në proporcion me punën. Edhe pensioni familjar njëjtë. A mundemi me ndërru, a me lon kështu. Ma e keqja është në rastin kur mbetesh invalid me vetëm 80% paaftësi, shteti nuk të jep kurrgjo. Në anën tjetër, i kemi invalidët e luftës, të cilët 20% me qenë indvalidë, i marrin 220 euro.

E kemi shtyllën e dytë – trustin – na të rinjtë po pagujmë në trust prej 2002, njerëzit që dalin tash në pension, maksimum marrin 40 muj, mas 40 mujve, kthehet në 75 euro. As kjo s'është e drejtë. Se sa do që i run, mas 100 mujve, i hargjon.

Edhe shtylla e trete- vullnetare, aty kush ka ma së shumti pare me lanë anash.

Dmth këto tema edhe të tjerat që nuk i hapa, pres prej juve propozime, që me mujtë na me i diskutu me grupin punues edhe me lobu për këto propozime. E hapi diskutimin!

Folësi 1:

Unë isha kon i propozimit që… ata njerëz që i marrin kah 4 mijë euro në Gjermani e kudo e ato 75 euro që i marrin në Kosovë ia japin naj familjari. Unë isha kon i propozimit që ata që marrin pensione prej jashtit, me ua ndalu këto të Kosovës. Menoj që njerëzve që i kanë largu prej punës, pra ata s'janë larguprej qejfit prej punës, atyne me ua njoft stazhin. Edhe ata që për 1 vjet s'mujnë me mrri 15 vjetshin, me ua njoftë edhe atyne përvojën e punës se ata s'janë largu me qejf prej punës.

Pensioni duhet me qenë së paku 250 euro nëse ka mundësi. P.sh mu më duhen 25 muj me marrë pension prej 186 eurosh që me mujt me mbërri rrogën e kryeministrit për ni muj. Kjo s'asht e drejtë.

Folësi 2:

Na kur po shkojmë me i marrë pensionet në Serbi, ata po na thonë që duhet me hjekë dorë prej pensioneve në Kosovë që me mujt me marrë atje. Po po kemi problem me Ministrinë këtu. Po problemi është që këta qe janë 65+ nuk janë pensionista, këta e marrin pensionin e pleqërisë edhe dallojnë prej neve që e marrim pensionin kontribuitiv. Duhet me hjekë pensionin 75 euro. *Folë për gjykatën e Strasburgut edhe për avokatët e noterët në Serbi.* Dmth nuk duhet me qujtë pension këtë shumë që e marrin, me u qujtë ndihmë sociale e pleqërisë. Tash lajmërun prej Beogradit që Serbia po lypë vërtetim se po dojnë m'i pagu pensionet. Vec po dojnë me hjekë këtë që po e marrim në Kosovë. Ose duhet me ulë këtë 75 euro. Pse po marrin edhe ata që s'kanë pagu kontribut pension prej 75 euro. Ose duhet me hjekë 75 euro.

Folësi 3:

Se ky p.sh e con vërtetimin edhe ju thotë unë i marr 230 euro, e ai thotë jo ty në Serbi të takon 200, pse me ta dhanë edhe pjesën tjetër, po nëse ia con me shumë ma të vogël, atë diferencën me ia pagu.

Folësi 4:

E qysh nana, baba jem që kanë punu, i bjen që s'kanë dhanë kontribut a?

Falemnderit shumë që na e keni bo këtë mundësi për me i marrë propozimet tona. Edhe atëherë kur u kon në vizitë Abrashi, edhe sot edhe nesër edhe cdo ditë, deri sa të kom fuqi me folë, nuk kom mu nalë tu folë për problemet që janë. Unë kam thanë që edhe stazhi edhe kualifikimi duhet mu njoftë deri 98-tën, po edhe ti ke thanë që vec e kanë vendos qashtu. Për mu problemi kryesor asht stazhi i punëtorëve. Prej t'90ave, punëtorët e largun prej fabrikave e vendeve të tjera të punës, e besoj që ma t'parët jemi na të fabrikave të Prizrenit. Edhe ata të administratave në Prizren, nuk kanë dalë për punë qefi. Kanë dalë se nuk jemi solidarizu me masat e dhunshme. Krejtve duhet me u njoftë përvoja. Pse mos me iu njoftë, ton ai kontribut; pse patriotizëm kanë bo vec arsimtarët e profesorët e Kosovës e na punëtorët s'kemi bo kurrgjo. Unë prej 90-tës jom në kryesi të BSPK-së e deri kur ka përfundu lufta, e edhe mas luftës. Po secili punëtor – e ata që s'janë largu prej punës se janë pajtu me regjimin – ata e kanë edhe stazhin edhe kanë marrë rroga të mira atëherë. Kërkush su largu me qejf prej punës, krejt janë largu me dhunë. Unë s'jom pajtu as me 15, as me 10 vjet. Unë jom me bo me përqindje. Se me bo me caktu për 10 vjet, ai tjetri për 9 vjet e 9 muj sun e merr. Dmth s'ka zgjidhje. Stazhi duhet me u pranu deri në ditën kur ka fillu m'u jap 75 euro. Pension osht ai. D.m.th deri ne 2002ten. Masnej nese don me lidh; qysh Kosova more nuk e pranon stazhin e vet. Mas luftës nuk ta njeh stazhin, kerkund në botë nuk ka kshtu; stazhin e vet mos me njoftë. Komplet mas luftës duhet mu njoftë stazhi. Trusti o kursim bre. Trusti duhet me kon kush don, në baza vullnetare. Nëse hin trusti edhe stazhi, gjysa e shpenzimeve të shtetit mbulohen. Neve na duhet fondi pensional. Na duhet vërtetim që dëshmon a merr diku tjetër jashtë pension a jo. Ka ma shumë fitim Kosova nëse ata e marrin vec pensionin e jashtit e jo këto të Kosovës se i ndihmojnë ekonomisë së Kosovës ma

shumë. Se ata i marrin 3 mijë franga, ama i shpenzojnë në Kosovë. Po ata i marrin edhe atje, edhe këtu ia lojnë dikujt të vetit.

Folësi 5:

Na jemi të diskriminum me këtë ligj. E dyta që thatë ju pensionet në Serbi, kjo osht rrenë. Djali i tezes tem para 4 vjete u pension prej serbise, i merr 250 euro. Unë pajtohna me drejtorin cka tha. Le të formohet fondi i pensionerëve. Kur kemi qenë si fmi, si nxansa, e kemi në libra aty ni plak që ka mjell. E nxensat e kanë pyet pse po e mjellë këtë pemë, ti si prêt frytet e tyne. Edhe plaku iu ka përgjigj nxansave: kanë mjell të tjerët, kam hangër unë, po mjelli unë, le të hanë të tjerët. Na kemi mbjellë, kanë hangër të tjerët, tash kta po mbjellin e po hanë vetë. Fondi duhet me u themelu mrena shtetit edhe me marre pension deri ne vdekje. Kur të formohet qai fondi, qai ligji i pensionerëve, atëherë kërkujt nuk i soset fondi deri në vdekje. Po e kanë cu trustin jashtë diku, kamatat i shfrytëzojnë vetë dikush. E ai kryetari i Trustit e ka rrogën 6 mijë euro. Ministria e din edhe pa propozimet tona se çka duhet me bo e cfare ligje duhen me pru.

Folësi 6:

A duhet tash për shembull me specifiku që mas vdekjes së personit kush e merr pensionin?

Folësi 4:

Nëse familjari vdes, vendoset pak ma ndryshe. Nëse unë e kom pasë pensionin 180 euro mesatarja, familjari e merr me përqindje. P.sh 60%.

Folësi 7:

Unë shkurt po foli se ju po i dishi punët krejt mirë, edhe boll u folë. Pensioni prej 75 euro me u shly. Nuk duhet me i thanë pension. Pensionit bazë duhet me iu ndrru emri. Stazhi duhet mu njoftë sipas përvojës së punës, jo të shkollës. Këta që e marrin pensionin jashtë, nuk duhet me i marr 75 euro. E qikjo 75 euro që iu hiqet atyne me iu rritë pensioni të moshuarve. Shumë logjike është kjo.

Folësi 6:

Duhet me marr yrnekë për ligjet që bohen në Kosovë. Shkolla nuk duhet mu marrë për bazë kur të bohet rritja e pensioneve, po përvoja. Shkolla duhet me ra në ujë. Jo në bazë të shkollimit, po në bazë të kontributeve.

Folësi 4:

E vërtetë që ka qenë në bazë të rrogës, po kurrë s'ke mujt me pasë rrogën ma të madhe se aty ku ka qenë drejtori a ai që ka pasë fakultet. Apet del ma e madhe te ata. Ai që e ka pasë fakultetin në cfarëdo fabrike, e ka pasë rrogën ma të madhe. Apet i del ma e madhe, si me shkollë si me rrogë. Në bazë të stazhit.

Folësi 8:

Qëllimi i reformave është më ndërtu ni system të qëndrueshëm pensional e jo me qenë afatshkurtër. E që me ia pa hajrin krejt gjeneratat, e jo vec kjo gjeneratë. Unë isha nalë te pensionet

kontributpaguese, mos me qenë e limitume në 15 vite, po mu bo kategorizimi. P.sh ai që e ka 9 vjet e 9 muj me kalu në kategori tjetër. Dmth mu bo 5 – 10 – 15, nëse se përmbush 15 vitshin, me kalu te 10 e kështu. E jo për 1 ditë me eleminu krejt. Me u kategorizu me përqindje.

Folësi 9:

Ekziston rasti kur ai e ka stazhin po te na nuk dalin shënimet, edhe ato nuk llogariten edhe met pa i marrë. E për shkak që hupin shënimet e nënshkrimit etj, e me t'cilat munet me fitu dicka, bash për qato met pa marrë kurgjo. Se na po i dëmtojmë qytetarët tonë.

Folësi 4:

E vërtetë ka raste, po janë shumë pak. Se janë zgjidh këto probleme. Se u marr vendim se ke a s'ke stazhi, a ka vërtetim a jo; vec a ka punu. E qysh e kemi gjetë a ka punu, kemi shku nëpër firma edhe nëse ka figuru në listë, e kemi bo fotokopje edhe u kry. Po ka edhe që e kanë librezën, po nuk figurojnë kërkah. P.sh financat, taksistat, dyqanet etj. Nuk i kanë.

P.sh na krejt po folim që këta të jashtit po i marrin dy pensione. Po shkoni nëpër shpia të tyne në Kosovë. Asni cent nuk e kanë pa pagu, krejt shpenzimet i kanë të pagume.

Fokus Grupi V

Gjakovë

Folësi 1:

Unë po e japi ni mendim temin. Unë s'po shoh, në vitet e '90 u kon ni vendim që me iu pranu stazhi gjithkujt që e ka largu Serbia. E mu po më intereson qata 32 mijë serbë a marrin pensione bazike a kontributive. Në qoftëse qita e marrin sipas kontributit, ky osht ni defect i shtetit, se na e dimë që beogradi i ka vjedh krejt, edhe fondin pensional edhe sigurimin social. E s'po di shteti cka ka vepru. Nëse 1 person ka punu në Gjermani e e ka arrit kuotën, ai e merr edhe këtu edhe atje, s'munesh me ia nalë. E për serbë, këto janë paret e Kosovës. E sa i përket skemës së dytë, osht mirë mu bo unike për të gjithë. I njëjti kriter me vlejt për krejt sektorët, jo vec për arsim e vec këta që si kanë qit prej pune. E sa i përket këtyre të invaliditetit, gjithkun n'botë osht nëse i ka 20% paaftësi ai e merr pensionin. Dmth 80% e rrogës bazë edhe masnej ajo e invaliditetit. Edhe nëse vazhdon me punu. Zakonisht i ndërrohet vendi i punës, ama i takon pensioni.

Folësi 2:

Mos po e ngatërron pak? Jo që e pagujnë 20% ama ai punon me orar të shkurtë nëse ka invaliditet.

Folësi 1:

Unë jam shumë i sigurtë për kto. Muni me kqyrë edhe me gjetë. 20% e ka plus orarin e shkurtë. E sa për trustin, unë s'po di a osht privat a i shtetit. Nëse osht shtetëror, gjithkun në botë gjenerata e pagun gjeneratën. Se kurrë 1 shtet nuk ka aq shumë pare në trust që m'i rujt qato pare, po qajo gjenerata me pagu tjetrën. Trusti me ekzistu privat, jo qishtu.

Folësi 2:

Moslajmërimi mas 6 mujve, nuk lajmërohet 2 muj edhe i hup pensioni kontributiv. E ku osht e drejta me ma nal pensionin kontributiv kur unë jom gjallë? Me bo mu lajmëru 1 here në vit. Nuk ka të drejtë me ia nalë pensionin nëse s'lajmërohet.

Folësi 3:

Ni dallim me ba në mes të pensionit bazik dhe kontributdhanësit. Ai kontributdhanës munet me shku deri 1 vit pa u lajmëru, mirëpo këtë tjetrin e kisha cu pension social.

Folësi 2:

Këto pensionet që ju kanë pagu t'vdekurve nuk u kon faji i shtetit, po kur ia ka fillu mu apliku sistemi me gjoba për ata që nuk i çlajmërojnë të vdekurit në baza kompjuterike, e kur kanë fillu kuvendet komunale me pagu kah 170 euro për ç'lajmërim, mo s'ka pas problem. Nësë mrena mujit nuk e kanë clajmëru, kanë pas gjoba. Në Prizren gjoba osht 50 euro.

Folësi 4:

Na problemin me rastet e këtyre të vdekurve e kemi se në terren jon ndrru adresat e sene; po besoj që me përkushtim rregullohen këto sene. Po e mira e mirës ish kon mu bo si para lufte, me iu pagu pensioni 3 muj mas vdekjes familjes, e ata na kishin ndihmu edhe neve. P.sh këto mjete kishin shërby për shpenzime të varrimit e këto. Se p.sh te personat me aftësi të kufizume, kur vdesin, e i thërrasim familjet me i lajmëru, ata refuzojnë, po kur i përmendim që u kemi dicka borxh, ata vijnë menihere të nesrit. Se na stafin se kemi tamon, e veturat zyrtare si kemi funksionale.

Folësi 5:

Unë kisha propozu që komisioni me kry shumë ma shpejt punën e ndërmarrë. Ligjin aktual ne si sindikatë e kemi kundërshtu që në vitin 2014. Arsyet e kundërshtimit jon hala sot valide dhe shumë të logjikshme se ky ligj e parasheh themelimin e fondit pensional kah fundi i mandatit të qeverisë së kalum. Kah fundi thotë. Qysh në vitin 2007, FSP ka propozu masat konkrete qysh me u rregullu ceshtja e kontributpagusve. Kërkesat ua kemi dorëzu krejt instancave. 1) Të parashihet themelimi i fondit pensional edhe e kemi a5rsyetu me faktin se se nëse themelohet fondi pensional, do të lirohej buxheti i kosovës prej pjesës që dedikohet për pensione. Se fondi i parasheh 11 burime konstante prej të cilave fondi plotësohet dhe bohet i aftë me i pagu pensionet. Mirëpo edhe ish kryeministri Mustafa nuk e ka marrë seriozisht. Prej fondit pensional me u pagu vetem pensionistët kontributpagues. 2) Kundër 2 pensioneve se Serbia, neni 119, e ndalon pagesën e 2 pensioneve. Krejt shtetet e rajonit e kanë qeshtu. Pse mos me shti edhe na në ligj. Duhet me pastru listën. 3) Nuk jemi kundër stazhit, përkundrazi kërkojmë që stazhi me u vlerësu në instancat ma të larta. Mendojmë që qikjo kategori (kontributive) ka vlerë të jashtëzakonshme për ndërtimin e shtetit.

Folësi 6:

Paret qe i kemi lon na, ato si kemi. Na i kanë marrë.

Folësi 7:

Këtu kanë fillu gabimet me fillim. A u diskutu najhere ceshtja e pensioneve ne Strasburg? Unë kom ardh me diskutu ne lidhje me pensionet e kontributpagusve. Që janë grabitë prej Serbisë. Sa për tjerat, këto diskutime i kemi që s'di sa vjet. E sen su bo. Vendimi i Strasburgut me kalu në Kuvend. E mandej pensionin familjar, nuk e di qysh osht e rregullume. Unë propozoj me qenë 60% e pensionit.

Folësi 8:

Skema pensionale duhet mu hjek krejt e me u formu ligji pensional. Duhet me u kategorizu ndryshe, jo shkolla e mesme, fakulteti. E te fakulteti e kemi shti me 1 vend MA, BA, akademikun etj. Këtu duhet me bo ni klasifikim se nuk bon si ai që e ka maru fakultetin sot a neser, si ai që ka punu nuk e di sa vite, e tash me marr njëjtë si ai që e ka kry para 10 vite. Me mujtë mi gjetë M4-shat, shumica duhen mi pasë këto e me u pagu përmes këtyne.

Folësi 9:

Na krejt u pajtum që gjenerata me përcjell gjeneratën. Na krejt cka kemi punu kemi dhanë kontribute. Pensionieri atehere i ka marr 400 – 500 euro, e sot ku jemi? Në Decan, 16% janë kon punëtorë të krahut. Unë jam i propozimit që edhe ata punëtorët e krahut e të minierës me hi në qat kategori qaty. E meritojnë se kanë punu fizikisht, e në kushte të rana. Udhëtimet e banjat, i përmendën edhe shokët e mi. Na i kanë siguru këto beneficione. Ma s'mrami e kom ni alternativë që me u cu në protesta edhe na në Prishtinë. Suxhukë e gazeta ka boll.

Folësi 10:

Tash krejt osht tu u ndërtu në bazë të skemave pensionale. Varet prej perceptimit se sa skema janë sot. Unë gjithë kom thanë që skemat pensionale nuk e zgjidhin cështjen. Na kemi skema po na nuk kemi system pensional, a system te sigurisë sociale. Pensioni merret me pleqni/ pensioni i pleqnisë. me Invaliditet/ pensioni invalidor edhe me vdekje/ pensioni familjar. Na ni kohë i kemi ndëgju symshelë Fondin Monetar e Bankën Botërore.

Ma herët e kemi pasë vecmas pensionin invalidor edhe mas 65% pensionin social. Tash më doket dojnë me ia ngjitë prapë emrin qashtu, pension social që për mu osht ma e arsyshme. Po ndërkohë janë formu skema tjera që për mu janë skema politike. Se ata që kanë pasë fuqi te kryeministri, e kanë kriju skemën e vet. P.sh te verbërit, tetraplegjikë etj. E ai p.sh neve na vinë personat në karrocë që sun lëvizin, edhe e marrin pensionin, po na vinë tjerët që janë të palëvizshëm ama s'janë të diagnostifikun si tetraplegjikë, e se marrin pensionin.

Në rajon e kanë shumë të qartë për këtë cështje, na duhet me këqyr cka kanë bo ata e cka mujna me marrë prej tyne tu e pasë parasysh edhe gjendjen tonë ekonomike se ndryshe s'bon, pa ia përshtat. Krejt shtetet janë tu ik prej fondeve shtetërore, janë tu i bo fondet private. Që mos me intervenu shteti. Shteti intervenon vec kur hin nën ujë.

Skemat janë shumë e bohen edhe ma shumë nëse bohen edhe skemat për policë e për grupe tjera. S'munen me ndodh këto.

Modeli gjenerata për gjeneratën osht i vjetërum, osht i reformum. Ka shumë ndryshime.

Sa i përket invalidëve, 20% nuk ka ekzistu. Pavarësisht invaliditetit, ata janë pagu edhe kanë vazhdu me punu. Po me u pagu pa punu vec nëse e kanë pas invaliditetin 80% e sipër.

Sa i përket stazhit, i kemi tri lloje: Stazhin e sigurimit 5+5

Trusti ma herët u kan vec ni model: gjenerata për gjeneratë. Tash reforma që ka fillu që moti.

Në Kroaci e kanë nda me kohë:

20% kontributi i plotë, prej tyne 15% i shkojnë në fond, secili person që hyn në punë i jipet numri i sigurimit edhe 5% paguhen për trust. Po gjenerate për mbi 50 janë deklaru a po dojnë me iu krejt 20% a po dojnë me iu nda 5. E neve s'na kane pyt a po dojna me hi ne trust a jo.

Fokus Grupi

Prishtina - OPAK

Folësi 1:

A bon vec 1 koment, sa i përket për pensione për persona me aftësi të kufizume. Po flas, sa i përket concept dokumentit, ku kemi punu krejt organizatat. Ne e kemi ideu dhe kemi mendu që ky koncept dokument ka me mbështet edhe çështjen e punësimit të këtyre personave me aftësi të kufizime. Ne kemi mendu që nëse ni person i këtij grupi punësohet, ai prapë do ta marrë ni mbështetje financiare, mirëpo nuk duhet ta marrë mbështetjen e njëjtë si ai që është i pa punësum sepse nevojat nuk janë të njëjtë normal. Pensionet për këtë grup janë të futura në Ligjin për pensione që financohen nga shteti edhe me këtë ligjin e ri që po shpresoj që patjetër ka me u bo ky ligj. Na mendojmë që ky ligj duhet me trajtu komplet situatën e personave me aftësi të kufizime në aspektin social prej lindjes deri në vdekje. E na duhemi me bo që me qenë sa ma kjartë në këtë ligj edhe sa i përket pensioneve se tash na i kemi do ligje për të verbër dhe tetraplegjikë që e trajon edhe çështjen e punësimeve për këto dy grupe, mirëpo këta tjerët qysh po mbesin. Unë edhe ma herët kom mendu që osht diskriminuese me fut një person 18 vjecar në skema pensionale. Na kemi telashe se nëse na e përfshijmë në ni projekt ni person me Syndromën Daën, atij atje automatikisht i ndalet pensioni.

Folësi 2:

Unë e kom ni propozim konkret, te personat e verbër, ekziston që ky problem u paraqit edhe te personat tetraplegjikë dhe paraplegjikë. Te personat e verbër mbi moshën 65 vjete, marrin kompensim po tani iu mohohet e drejta e pensionit kontributdhënës. Qitu kisha me folë.

Folësi 3:

Fillimisht duhet me u ndalë te përkufizimi i pensionit, që për mu nuk osht e njëjta. Definitivisht duhet me u nda edhe në terminologji edhe në zbatueshmëri reforma e sistemit pensional sa i përket pensioneve edhe kompensimit për personat me aftësi të kufizuara. Propozimi jem osht me u specifiku cili lloj quhet pension, cili quhet kompensim. Ata që marrin për shkak të aftësisë së kufizime duhet me u shënu me një skemë të veçantë, e cila nuk duhet të përfshihet në koncept dokument të skemave pensionale të financuara nga shteti. Mendoj që osht konflikt ligjor edhe nuk përputhet me realitetin e praktikën. Te ligji për të verbër dhe tetraplegjikë, nuk i mohohet e drejta e punësimit, p.sh ni i verbër apo paraplegjik që e merr ni kompensim, ai ka t'drejtë edhe të punojë. Edhe duhet me u ndjek ky model e të jetë ligji gjithëpërfshirës se personat me aftësi të kufizume nuk mund të flasim për integrim të tyne nëse atyne nuk u jepet e drejta për punësim, por kompensimi e barazon, dmth e kompenson në aspektin që ai me pasë ni qasje ma të lehtë në punësim. Dmth e barazon me njerëzit e tjerë. Propozimi jem i dytë osht që duhet t'u njihet e drejta e pensionit kontributdhënës, nuk ka rëndësi sa osht shuma e përqindja, ajo s'mund të jetë e barabartë. Nuk mundet p.sh një i verbër që i merr 275 euro, ta merr kompensimin e plotë sa osht aktualisht, pavarësisht përgatitjes profesionale, po të bëhet një lloj përshkallëzimi me përqindje, por nuk duhet

të eliminohet krejtësisht. Propozimi i tretë, duhet të rishikohet ligji i auditorit të përgjithshëm dhe i skemave pensionale, se ligji i auditorit të përgjithshëm i njeh dy skema; pagën dhe pensionin. Nuk e njeh kompensimin financiar për persona me aftësi të kufizume, prandaj ka ardhë deri te iniciativë e ministrisë së punës për me i ndërpre skemat e dyfishta të financuara nga shteti që për mu në atë kohë ka qenë plotësisht në kundërshtim me etikën ligjore, njerëzore. Sepse auditori nashta ka pasë të drejtë se ai i njeh dy skema. Po problemi ka qenë te konflikti mes auditorit dhe ministrisë . Ministria i ka shti dy skema në fuqi pa u konsultu me ligjin e auditorit. Prandaj këto qenë tri propozimet e mia. E te ky koncept dokument duhet të njihet modeli i kompensimit dhe duhet të ketë një lloj përshkallëzimi, nuk mund të ketë kompensim të njëjtë për atë që ka 100% invaliditet, si ai që ka 30-40% invaliditet. Po edhe ky i fundit duhet të ketë një shërbim të caktum, jo detyrimisht financiar, po që i shërben integrimit të tij ma të lehtë. E për me pasë një dokument sa ma gjithëpërfshirës, mendoj që duhet të mjeket termi pension meqë osht shumë diskriminues dhe duhet të ketë shumë kujdes te kompensimi dhe termi pension. Se nëse edhe me ligjin e ri kompensimet i quajmë pensione, na praktikisht s'kemi bo kurrgjë.

Folësi 4:

Kem tu fol për pension edhe kompensim, nashta jemi shtet i ri e s'po muj me folë se po bi në kundërshtim me veten. Kur po folim te pensionet - beneficione/kompensime – të verbërve, tetraplegjikëve e paraplegjikëve. S'po pajtona pak. Pensionet po thoni që kontribuojnë, s'po du me folë tash, nëse del udhëzimi administrativ na kontribut s'jepim, kthehen qato pare. Tatim shtetit si pagujmë. Unë menova që p.sh mos jemi tu e lyp edhe pensionin bazë, 75 euro.

Folësi 3:

Pavarësisht a pagujnë tatim a jo, unë menoj që ata që punojnë, ata duhet me fitu një përqindje prej ligjit se ne krejt botën fitojnë, dmth mas 65 vjete. Me ligjin që u kon deri në 2014, një person i verbër mas moshës 65 vjecare ka përfitu pensionin e punës ose të pleqërisë edhe kompensimin. Ka qenë pjesë e kësaj skeme deri sa u ndrru udhëzimi administrativ.

Folësi 4:

Unë po menoj që so e logjikshme, p.sh pi marr 370 i merr ni tetraplegjik plus pensionin e pleqërisë, e kur plakna nashta bohna edhe tetraplegjik, e me lyp edhe pensionin e pleqërisë; e ma shumë kisha dasht me rritë këtë benefit se sa me lyp edhe ni pension tjetër. Qito kompensimin dmth me rritë gjatë pleqërisë se edhe kompensimin edhe pensionin. Se s'po muj.. Dmth mos me pasë edhe pensionin bazë.

Folësi 3:

Që mos me marr biseda krejt tjetër kahje. Ni propozim osht që mas 65 vjete, me u qujtë pension. Se edhe mas 65 vjece tek të verbrit quhet kompensim, jo pension.

Folësi 5:

Po këta s'munden me pasë pension të përhershëm se çdo tri vjet iu rivlerësohet gjendja, s'mundet me u thirrë pension i perhershëm se mundet me iu përmirësu gjendja.

Folësi 4:

Qitu deshta mu lidhë, jo mu qujt pension, po me u rritë kompensimi se njeri tu u plakë ka edhe ma shumë nevoja. Dmth këta që kanë paaftësi të përhershme, e jo me i marr dy edhe kompensim edhe pension.

Folësi 6:

Ligjin pe dimë të gjithë. Na i qujmë ligjet që kanë të bajnë direkt me personat me aftësi të kufizume. Shumat po i dimë, du me u nal te pensionet e PAK. Prej 2004, na kurrë s'jemi pajtu me definicionin se pension mas moshës 18 vjecare ti po ia hupë të drejtën e punës, ai s'mujke kurrgjë ma tepër me marrë. Ka shku në bazë lineare për të gjithë, su marrë parasysh a osht fmi a i rritur. Aty vlerësohet paaftësia për punë, jo aftësia e kufizume. E aty hynë edhe personat që kanë p.sh sëmundje të zemrës, jo vec këta me aftësi të kufizume, dmth të cilat janë të paaftë për punë. Nuk vlerësohen nevojat e secilit. Tash, fjala kompensim që po e përdorim shpesh, e kësaj duhet me ia shtu edhe kompensim për shërbimet e domosdoshme mujore. Se shteti nuk ofron kurrfarë shërbimi tjetër për këto grupe, për atë arsye duhet me i mbulu financiarisht atë person e atë familje, në atë mënyrë që ata me pagu kujdestarin apo përcjellësin, me pagu rehabilitimin. Dmth kompensimi osht për qito. Dmth nuk duhet me u qujt pension. Te termi trajtim i barabartë – dmth duhet me qenë në bazë të nevojave. Na kemi bo komente edhe ia kemi dërgu ministrisë edhe krejt shoqatave që kemi kërku qysh vite ma herët që do të duhej të ishte ni ligj që do ta definonte statusin e PAK. Pamarrë parasysh fare nevojash do të ketë ai, do të duhej të definohej statusi. Ka PAK të cilët kanë kufizime po nuk ka nevojë për shërbime apo kompensim, po atij duhet me iu ofru mundësia për angazhim në punë. Nëse e marrim këtë koncept, ky dokument i referohet ma shumë punësimit të PAK, ma shumë ka të bëjë me ni hulumtim se sa ni koncept që do ta definonte që do t'i paraprinte ligjit gjithpërfshirës. Na s'kemi marrë përgjigje a janë pranu komentet tona. Ky koncept dokument ish dashtë mu finalizu edhe me na tregu qartë si qëndron situata. Kjo na e kish lehtësu neve shumëcka, jo shuma. Po ligji duhet me i vlerësu secilin person sipas nevojave. Tash mënyra qysh duhet me u marrë këto, si p.sh Serbia, qysh e kanë qujt ndihma e huj, ata e kanë ni shumë të përafërt për të gjithë personat që vlerësohen me AK, mirëpo shteti ua mbulon të gjitha shërbimet e tjera; rehabilitimi e kujdesi. E Kosova nuk i bon këto, e për qato e përmenda shumën që me i kompensu shërbimet e nevojshme mujore. Për dikon munet me kon kompensimi i mjaftushëm, e për dikon jo. Me pasë ofru shteti shërbime sipas nevojave, atëherë kish mujtë me thanë që PAK po trajtohen barabartë. Shteti duhet me bo vlerësimin e jo shoqatat.

Folësi 1:

Më fal që po të ndërprej. Pa dashtë me gjyku kërkon, po du me shpjegu pak kronologjinë e këtij dokumenti. Nuk osht problemi vec te shteti, duhet me qenë pak vetëkritikë. Prej përvojës tem personale, kanihere zyrtarët nuk i kanë as njohuritë minimale sa i përket AK. Po problemi osht që as ne s'kemi funksionu si një trup i përbashkët që me i plasu interesat e të gjitha PAK. Ka qenë viti 2015 nëse nuk harroj kur ka qenë ni punëtori e thirrun prej MPMS. Në atë kohë kemi qenë në proces të hartimit të këtij ligji për tetraplegjikë dhe paraplegjikë, edhe kom thanë që ju këtë ligj e keni gati e hajde të flasim edhe për tjerët. Edhe kom kërku që po bohem krejt bashkë, po punojmë intensivisht edhe pe bojmë ni dokument gjithëpërfshirës ku trajtohen nevojat e krejt PAK. Nuk ka pasë vullnet

me u bo. Edhe pa modesti po them, mos me pasë qenë projektet e DSK, s'ishin mbajtë ato punëtori. Se s'ka pas asni buxhet të planifikum. Tjetra, ma s'po muj me pranu kësi komentesh që po thuni që s'keni njohuri për koncept-dokument, e keni pasë ni person aty edhe ton kohën kemi bo presion. Edhe unë kisha mujt me i përdor lidhjet e mia qysh përdoren në Kosovë edhe me cu ligjin për personat e DS. Ligjet e veçanta që jon bo janë shkelje e Kushtetutës. Institucionet u dasht me i ndalu krijimin e ligjeve të veçanta. Problemi osht te vetë na përfaqësuesit e shoqatave se duhet të shohim ma larg, jo vec personat që na i përfaqësojmë. Unë gjithë kom thanë, cka ata që se përfaqëson kërkush, kush duhet me mendu për to? Shteti s'po mendon.

Folësi 6:

Cka tha kjo, nuk qëndron aspak. Unë po thom që komentet që i kom dërgu, nuk e di a janë përfshi.

(Disa akuza në mes njëri-tjetrit)

Folësi 2:

Reforma pensionale që synohet nuk e di sa përputhet me ligjet ekzistuese për PAK. P.sh. te kompensimet e të verbërve, dhe paraplegjikëve; për mu janë dy ligje që nuk duhet me hi në reformën për pensionet e financuara nga shteti se janë dy ligje që nuk quhen pension. Atëherë me çfarë argumenti këto dy ligje mujnë me hi në reforma? Koncept-dokumenti që bohet për PAK, nashta duhet me u reformu krejt ligjet për PAK që të ketë barazi në bazë të nevojave. E a ka lidhje kjo me reformën e sistemit pensional? Ligji gjithëpërfshirës për pensione edhe reforma pensionale janë çështje të ndryshme. Kjo reformë s'ka t'bëjë me ligjet e tjera për PAK.

Folësi 7:

Po më duket pe kuptoj çështjen; nëse kompensimet quhen pensione atëherë duhen me hy në reformën e sistemit pensional të financuar nga shteti, po meqë s'quhen pensione sipas ligjeve, a munden a jo me u fut në këtë reformë. Po kisha thanë se kjo so najfarë telashe, se në disa vende osht p.sh ligji për mbrojtjen sociale e ku jon të futun edhe PAK, edhe familjet sociale e të gjitha të futuna me ni ligj, e brenda ligjit ndahen. Qiky koncept diku thotë kanë mu ndryshu, kanë me u shfuqizu, diku thotë kanë me nejtë këto. A punojmë na dicka kot qitu, ku ajo atje mundet me ndrru.

Folësi 4:

Qe 5 vjet ky koncept, kanë fitu 2 kategori, na tjerat jashtë kemi mbetë, s'po du me pare mu kon i barabartë me ty. Që 5 vjet jon tu prit personat e tjera, hajt të verbrit mirë, hajt paraplegjikët mirë, kur erdh puna te na, krejt u cun në kamë. Nuk pe shoh të logjikshme. Secili grup duhet me folë për grupin e vet. M'keni lanë jashtë krejt ligjeve. Shurdhët janë lanë krejt jashtë.

Folësi 8:

Unë konsideroj se kategoria e autizmit osht kategoria ma e ndishme në shoqni. Në momentin që diagnostifikohet fmia me autizëm osht moment i vështirë për familjet. Realisht naj problem fizik a najsen të dallueshme në pamje nuk kanë. Zakonisht në 2 e gjysë diagnostifikohet edhe ajo osht bomba ma e randë për familjen. Këtë e kom përjetu edhe vetë. Osht ballafaqimi me e kyc në kopsht. Se puna intensive me fmi autistë munet me sjell progres të madh te fëmijët. E në Kosovë osht

problem shumë i madh. Ligji e njeh të drejtën e autistit për me pasë qasje në kopsht, po prindi duhet me pagu ni asistent që rrin aty ton kohen. Po flas për ni fmi 2 – 2 e gjysë. Për me pagu ni psikolog për fminë, minimumi osht 500 euro. Cdo i 60 fmi lindë me autizëm, e 50% e tyne janë me epilepsi. Fminë tem deri në 12 vjec më kanë thanë që ka elemente të autizmit, po unë e kam pa që osht autist se nuk ecke, e u dashtë me cu jashtë vendit me diagnostifiku. Njëjtë probleme edhe me regjistrim në shkolla. Prapë duhet me pasë asistent. Deri në moshën 18 vjece, të vetmen shpresë e kemi qendrën burimore të përparimit, cka tutje mas 18 vjet. Në moshën 18 personi me autizëm hin në kategorinë e pensionit 75 euro kur kërkesat janë shumë ma të mëdha. Ka shumë prindër, zakonisht nanat, e lajnë vendin e punës edhe mbyllen në shpi. Unë shpesh thom që na prindërit vetë pe bojmë shkeljen e të drejtave të fëmisë tonë se pe marrim pe mbyllim në shpi. Kategorizimi osht ofendim i randë. Fmitë mandej bahen agresivë e osht vështirë. P.sh këta asistentat që thojnë që janë në terren, kurrë nuk i vizitojnë kurrë personat autistë. Po cka ndodh kur s'asht prindi ma, kur plaket e s'o n'gjendje me këqyr fëminë e vet – Shtimja osht zgjidhja e vetme – e cili prind e bon ballë me cu fminë e vet aty tu e ditë cfarë kushte ka aty. Tmerri i tmerreve...

Folësi 9:

Unë po ndërlidhna, ky segment osht e vërtetë që trajtimi nga institucionet e shëndetësia për këtë kategori osht shumë i ulët. Psikiatri nuk ka lidhje me autista, po ju japin terapi si me qenë sëmundje të randa psikike e kështu i kanë përkeqësu edhe ata. Krejt duhet me punu për ta. Qasja osht e gabime edhe në këtë kategori. Ma s'miri osht me bo ni ligj pensional ku përfshihen të gjitha kategoritë. Koncept-dokumenti u punu që tri vjet me seriozitet të madh edhe janë përfshi organizata e shoqata lokale e ndërkombëtare, edhe ka ardh deri të zbehja e seriozitetit të punës për arsye se deri sa ti je i obligum me bo një ligj, e knej lejon me bo ligje anashkaluese për grupe të ndryshme, këtu ka ndodh zbehja. E për atë kanë mbet grupe të papërfshime, të margjinalizume. E ligji kish me e rregullu që secili grup me marrë një page/kompensim/pension se pavarësisht qysh e thirrë, nëse financohet nga buxheti i shtetit, osht pagë, osht rrogë. Kisha propozu që me bo pagesën e barabartë për të gjithë PAK, e nëse i takon edhe përcjellësi, edhe ai me qenë me pagë të njëjtë për të gjitha grupet. Nevojat e veçanta duhet me u rregullu me ligj të përbashkët. Me u barazu të gjitha kategoritë. Dmth disa që s'marrin pagë fare se e kanë paaftësinë e vogël, munden me marrë beneficione tjera/lehtësime, p.sh busin, a infrastrukturën.

Përderisa na kemi komente e kemi punu në koncept dokument, andej janë bo ligje të veçanta për arsye politike.

Folësi 10:

P.sh disa kategori e marrin vec pensionin kontributiv mas 65 vjec. Jo edhe atë të kategorisë. Se na nuk e dimë as sa persona janë PAK në Kosovë.

Folësi 1:

Reforma pensionale duhet me i prekë PAK mbi 65 vjec. Deri në 65 vjec, ato zgjidhen prej Ligjit gjithpërfshirës për të gjithë PAK. Na duhet me i përkrah të gjitha kategoritë edhe Ligjin që i trajton barabartë PAK. E mbi 65 vjec duhet me përfitu një përqindje të pensionit kontributiv.

Folësi 10:

P.sh. personi që ka jap kontribute edhe pëson lëndim, kalon në tetraplegjik. P.sh ai lirohet nga tatimi, e atij nuk duhet me ia pagu kontributet se ai nuk pagun për shtet. Unë jom kon kundër, edhe pse sot e gëzoj.

Folësi 11:

Nuk bon me iu ndalë kontributet pensionistëve se ata vetë kanë pagu. Fondi i sigurimeve shëndetësore që ka pasë mu bo, nuk bohet se ka shumë skema përfituese të këtij fondi. Prandaj, propozimi jem kishte me qenë që me u liru prej pagesës së shërbimeve të gjithë personat me invaliditet mbi 80%.

Fokus Grupi

Prishtina –Ekspertët

Folësi 1:

Me shumë sene që i përmende ti, unë pajtohna plotësisht. Momentalisht, ligji osht i orientum ashtu që shteti e jep një prag bazik, e zgjedhjet na duhet me i gjetë në treg. Osht bo ni ndryshim aty, se roli i shtetit u rritë, po unë menoj që parimet bazë duhen me ndërru. Parimi i universalitetit, që nënkupton që sa ma shumë njerëz me u përfshi në skemat pensionale. E dyta, parimin e solidaritetit edhe parimin e barazisë. Ligji dmth duhet me u deklaru që i ndjek këto parime. Cka po nënkuptoj me parimin e barazisë; u përmend ma herët paga minimale, tash e kemi fenomenin e emigracionit që shumë njerëz po ikin se po thonë që këtu e kanë pagën minimale ma të vogël, pagën e përgjithshme ma të vogël; emigracioni osht i lidhtë me pabarazinë. Mendoj që paga ma e vogël që jipet prej pensioneve duhet me qenë gjithnjë e lidhun me mesataren e medianës në treg, dmth me të ardhurat e mesit në treg. Tash qysh mu nda këto skema: tri shtylla. Shtylla e parë duhet me pasë qit shtyllën zero që po thu edhe fondin e sigurimeve pensionale. Mirëpo mu menaxhu prej një institucioni; dmth komplet pensionet e ardhshme me u lshu prej këtij fondi. Tash unë pajtohna që shtylla zero me u kthy në pension shtetëror edhe me iu lshu të gjithë atyne njerëzve që i bojnë 65 vjet edhe të cilët s'kanë të ardhura tjera. Edhe të gjitha kompensimet për kategoritë e vecanta me qenë të njëjta, të barabarta. Dmth shtylla zero me qenë e barabartë për të gjithë. Krejt të ardhurat tjera, dmth pensionet kontributdhënëse me dalë prej buxhetit të shtetit edhe mu siguru prej fondit

pensional, dmth sigurim sociale. Tash qiky sigurim social duhet me u financu prej punëtorëve aktualë. Edhe unë pajtohna që duhet me u rrit për 7% edhe në anën e punëdhënësit edhe punëmarrësit. Tash e shpjegoj. Unë e shoh krejt ngarkesën 24% në të ardhurat reale gross, edhe shëndetësor, kontributdhënës etj. Shumica e ngarkojnë punëdhënësin ma shumë, po masi ideologjia jonë është m'i favorizu punëdhënësit, nuk ka ofru rezultate deri tash , unë prapë qëndroj me këtë, dmth 7 me 7 për pensione kontributdhënës e prej këtij me u financu edhe kontributdhënësit e ardhshëm. Me rujtë skemën e kursimeve të obligushme – se ajo s'osht pension. Mirëpo unë menoj që duhet me u zvogëlu kontributi që bohet. Dmth prej 5 + 5 me u bo 5 komplet. Se unë menoj që qito të ardhuna në terma afatgjatë janë të pasigurta, se e kom thon e po e thom prapë që na kemi lujtë bast. Se osht qashtu që kapitalizmi jeton me krizë edhe nuk ka ndonjë shtet që e dëshmon të kundërtën, dmth që të ardhurat në fakt janë të qëndrueshme. E besoj që nëse krejt na i rujmë qato të ardhura qaty, jemi në rrezik. Qata mendoj që osht në të mirën e stabilitetit tonë afatgjatë që qato të ardhuna me u zvogëlu pak edhe me u siguru prej të ardhurave të kanë garanci qeveritare. Tash nëse e zvogëlojmë në 2.5% mendoj që s'kemi nevojë me bo liberalizimin e bankave se në momentin që e zvogëlon, ti ki me rritë interesin për siguri në treg edhe përvec fondit kosovar-slloven kanë mu shtu të tjerët vet.

Në krejt vendet ku kursimi i obliguar nuk është i obligum, ka interes ma shumë.

Po më pëlqen edhe kjo ideja që këta veteranët, kujdestarët – nashta mujnë mu siguru me najfarë forme me ligjin e punës për punësim prioritar; nashta problemi i tyne duhet m'u zgjidh përmes kësaj forme.

14 + 5 + 7 (sigurimi shëndetësor) = 26%

Edhe elementi i fundit; pensionet e FSK-se dhe Policisë, na s'mundemi me kopju ligjin e mëhershëm me t'cilin janë rregullu pensionet për ushtri dhe polici se tash njerëzit edhe jetojnë ma gjatë. Menoj që minimum 60 vjet duhen me dalë në pension, s'ka arsye me dalë ma herët në kontekstin e sotëm.

Folësi 2:

Tash së fundi që e patem një takim me Ëashingtonin dhe MPMS, u përmend që do të bahet një concept-dokument të reformës së sistemit pensional, edhe na e përkrahëm shumë që të bohet ni reform tamon sepse grupe të caktume e kanë mënyrën e lobimit qysh e kanë përdorë deri tash edhe ka rezultu që janë rregullu me ligje te vecanta; edhe normal kjo e krijon pabarazinë që tash kur i pamë një nga një, e pamë që ka dallime shumë të mdhaja që s'ish dashtë me pasë. Edhe na e shprehëm interesimin që me u kyc në momentin kur ministria ta ofrojë ni concept-dokument me propozime ma konkrete. Jo vetëm na si FMN, po edhe ekipa në Ëashington që ka ekspertizë edhe prej veneve tjera se qysh e kanë rregullu. Besoj që unifikimi i skemave p.sh të invalidëve në një skemë ka me prodhu efekt. Propozimi që me u lidhë me pagën minimale, kisha qenë i rezervum se na janë ba shumë skema që janë lidhë me pagën minimale. Paga minimale i atribuohet ma shumë njerëzve që punojnë, e këta janë shumica që s'punojnë.

Cashtja e 15 vjetësisht para vitit 99, osht temë shumë e vështirë edhe secili ka të drejtë. Qysh the ti, na në fakt po ua njohim kontributin atynë që kanë qenë pjesë e sistemit, përderisa atij që e ka humbë vendin e punës, po i thomë valla ti s'ke punu 15 vjet. Po në të njëjtën kohë, nëse e lejojmë

totalisht, atëherë obligimi bohet shumë i madh. Përpjestimi për vite, nëse e kishim gjetë ni formulë, e kish kriju nifar barazie.

Pensioni bazë me të hyrat personale, kjo kish me qenë një gjë interesante. Po tash implementimi në terren…

Policia dhe FSK – kur ka qenë ligji për FSK, presioni politik ka qenë jashtëzakonisht i madh. Përndryshe na i kemi komentet tona aty që ky ligj s'është në rregull sepse e krijon bazën që shumë grupe tjera të kërkojnë 60-70% të pagës. Na po e shohim që vec po vjen e po rritet numri i kategorive. Tjetra, policia, kur ka ardhë ligji – na si FMN i kemi ofru komentet tona që thjesht boni do skenare, që mos të bahet sektori i policisë më atraktivja në sektorin publik. Se i jep mundësi si 37 vjecar me hi në polici edhe me shku në pension me marr 70% të pagës. Aplikoji kontribute shtesë. P.sh. polici fillon në moshën 25 vjecare me punu, po kontributet e tij pensionale janë më të larta se të të tjerëve për faktin se në moshën 50 vjecare del në pension. Ministria s'ka dashtë me bo ksi analiza, na si FMN nuk i kemi pasë të dhanat e duhura për policët; po prapë po vijmë të pika për skemat e vecanta. Mos ta përmendim ligjin për arsimin, ku e dimë që kontributi i tyne osht shumë i cmueshëm, po prapë po e shofim që numri i skemave po shtohet edhe osht jashtëzakonisht i padrejtë ndaj grupeve të tjera.

Për kontribute, në këtë pikë du me nda opinionin tem personal. Unë e kom përkrah idenë që si shtesë e 5+5 me shku me 3+3 shtesë. Dmth edhe 6% edhe kjo shumë përdoret për mbulimin e qityne skemave. Eksperti i cashtjes në Ëashington ai osht kundër se po thotë që po krijon obligime që se dimë kush ka me i pagu ma vonë. Dmth kundër shtyllës së parë. E ai osht një pikë konsulte për FMN.

Pjesën e veteranëve të luftës, rekomandimet tona kanë qenë publike. Fillimisht e kena përkrah idenë që me u pagu ni shumë e caktume. E ne fund politika e ka bo të veten. Osht kon kriter i FMN që cashtja e veteranëve dhe invalidëve të luftës të rregullohet me standarde ndërkombëtare dhe kategoritë e tjera.

Lehonat – Janë kon 2 ideja. U kon concept-dokumenti që u miratu në kuvend. Ministria osht tu punu që edhe lehonat e papuna me u pagu Na jemi kon kundër, e tani u kon ideja që barra me kalu prej sektorit privat në qeveri. Krejt pe bojnë maksimumin qe krejt barrën me zhvendos te shteti edhe osht problem.

Folësi 3:

Cfare mendimi ka FMN për Fondin?

Folësi 2:

Opinioni i FMN-së osht me vazhdu me shtyllën e dytë edhe s'ka fond.

Folësi 4:

Këto që e përmendet, kjo nuk osht vec reformë, po ma shumë se reformë. Reformë osht nëse ia dalim me kalu prej ligjeve të UNMIK-ut në ligjet që na përshtaten neve, se krejt problemin e kemi te ligjet që janë bo në kohën e UNMIK-ut.

Bazë të krejt këtyne problemeve e shoh mungesën e një sistemi informues – databazë në nivel nacional ku kemi qasje krejt institucionet. Se krejt shtetet tjera e kanë që përmes numrit personal mundet m'u ditë cfarë skeme sociale i përket etj. Këtë cashtje e kom ngritë në KE para 10 vjete. E ata janë zotu që e sponzorojnë një databazë të tillë, po politikës nuk po i konvenon. Se nuk kish ndodhë me qenë edhe veteran i luftës edhe në punë se e kish qit saktë kush cka pagun. Kjo i kish parandalu shumë keqpërdorime të tjera.

Duhet që secilit me iu vlerësu përvoja e punës aq sa e ka pasë; ose 1 vjet ose 2 vjet. Krejt duhen mu cmu. Cdo vit me u përpjestu.

Ni problem osht te kualifikimi shkollor, p.sh te shpërputhja e pozitës që e ka pasë edhe përgatitjes shkollore. Ish kon mirë edhe kjo mu sqaru.

Ni problem tjetër osht teknik; p.sh paraqitja fizike e pensionistëve. Mujna me shku sipas praktikave të vendeve tjera. Mu mbulu shpenzimet e varrimit të personit edhe mu dhanë së paku edhe dy pensione për familje. Ish kon stimulim që familja me lajmëru vdekjen e personit. Shpenzimi i varrimit + 2 pensione. Kish ra niveli i keqpërdorimit. Ose p.sh me bo që nëse nuk i tërhjek 3 muj pensionin prej bankës, me shku me ia bo ni vizitë ose me ia ndalë pensionin.

Ni problem tjetër te komisioni mjekësor edhe te vlerësimi 1-2-3 vjet. Ni person që osht i paaftë nuk shkon tu u përmirësu, po për shkak se mjeku i merr diku 1 euro për secilën kontrollë, ata bajnë kësi fiskulltura edhe kjo i kushton goxha shumë shtetit. E vlerëson paaftësinë në periudhe 10 vjecare ose të përjetshëm, me mundësi të rivlerësimit me ankesë.

Sa i përket përqindja e kontributeve për sigurime shëndetësore– shembulli i Malit të zi – 4.3% punëmarrësi, 8.5% punëdhënësi = 12.8%. Pensionistët pagujnë 1% për sigurime shëndetësore, rastet sociale e krejt i pagujnë por i mbulon MPMS.

Shtesat e fmive – me mujtë me shti edhe qit pjesë. Ama krejt duhet me u tatimu.

Folësi 5:

Ka bazë ligjore për këtë punë e paraqitjes së vdekjes së personave, nuk mundemi me i shiku gjanat njëanshmërisht. Duhen aktivizuar mekanizmat ekzistues që i kontrollojnë këto. 6 muajshi duhet hequr se është diskriminues.

Folësi 1:

Lidhja e sistemit kish me funksionu shumë mirë në këtë rast se Brenda 3 muajve p.sh ish ditë nëse personi ka pranu ndonjë shërbim publik, p.sh shërbim mjekësor.

Folësi 6:

Kjo reformë osht mjaft e vonuar, janë ba shumë eksperimente në Kosovë. Jo vec prej UNMIK po edhe prej neve. Ligji në fuqi, krejt ligjet në fuqi për FSK e tjera, nuk janë ligje të mirëfillta. Ligji për skemat pensionale as sot nuk ka zgjidhje financiare as juridike. Ky ligj osht kundër kushtetues. Na folëm për fushën e arsimit, kërkush so kundër tyre që mu shpërbly për punën e tyne. Po ata kanë marrë edhe atëherë. Jom për me zgjidh këtë cashtje, po jo me i shkelë ligjet dhe kushtetutën e me kriju pabarazi.

Pranimi i stazhit – neni 8, pika 6 – ky nocion osht i papërfillshëm, i pa përcaktum mirë, i precizum mirë, paraqitet pyetja kush janë ata tjerët? Unë kam dëgju që po kërkojnë paga, shpërblim, ata që e kanë mbledhë tre përqindshin, e ata që kanë dhanë ndihma tjera. Osht mirë mu bo reforma pensionale.

U përmend cështja e pranimit të stazhit 15 vjet. Na kemi kërku ose mu zbrit censusi 15 vjet në 10 vjet, ose mu pranu stazhi i të gjithëve prej 23 mars 99 që janë dëbu me dhunë nga serbët. Ajo kishte me qenë zgjedhja ma e mirë. Zbritja e censusit nuk osht zgjedhja ma e mirë, vec e zbut situatën.

Neni 8, pika 6 – i sheh tri kritere: kualifikimi, stazhi edhe kontributi. Kontributi osht lanë anash, merret si kriter diploma. P.sh nuk pranohet kontributi mas 1.1'99 po gjyqtarëve u pranohet provimi i juridikaturës. Na jemi ni qeveri ama kemi kritere të ndryshme. Mu njoftë kontributi. Mu njoftë përvoja e punës. Reforma duhet me u bo në dy drejtime: përmirësimi i ligjit ekzistues dhe reforma taman. Ekzistojnë evidenca për përvojën e punës. Ligji i detyron që mu rritë pensioni në bazë të kostos së jetesës. Nuk bahet, shkelet ligji.

Fondi pensional duhet me qenë Brenda Kosovës.

Folësi 5:

Fare shkurt. Meqë s'kam pasë kohë ta lexoj materialin, më mjaftoi fjalia e fundit që e keni thënë dhe mendoj se është plotësisht e qëlluar, pra në Kosovë lypset vetëdijësimi i të gjithë akterëve për nevojën e reformës rrënjësore. Kjo nuk mundet të bëhet as për një ditë, as për një vit. Ne duhet të kthehemi në modelin europian të Oto Bismarkut sic e kanë të gjitha shtetet në rajon dhe Europa. Osht e vërtetë që kapitalizmi jeton me kriza ciklike, po ai ka ekzistu edhe më herët, dhe po mbijeton duke i përshtatur mekanizmat përkatës socio-ekonomik rrethanave. Modeli i Oto-Bismarkut osht system që osht provuar rreth 50 vite në Kosovë dhe ka gjasa të riinstalohet. Ekziston ni ligj që osht punuar me kerkesë të qeverisë, në vitin 2004, e aty janë të parapara të gjitha këto që po i propozoni ju. Ai osht në sirtar të qeverisë. E cdo mekanizëm është i paraparë aty, vec mungon vullnetin.

FMN-ja, kam pasur takim me ta, ata nuk i kanë pranuar propozimet dhe idetë e mia. Po ata mund t'i zbatojnë politikat e tyre, por ne nuk jemi të detyruar t'i zbatojmë. E ai ligj është pranuar nga BE. Osht në frymën e modelit europian.

Ai model është i duhuri për një shtet që i ka 80 mijë pensionist dhe barrën kryesore e ka qeveria. Qeveria ngarkohet ma shumë me ketë sistem tani që është system korporativ. Të gjitha ato, kualifikimet e tjera, mund të rregullohen për dy javë.

Ligji aktual i sistemit pensional është përplot defekte, jashtëzakonisht diskriminues.

15 vitshi është diskriminues se dikush ka punu 40 vjet, dikush 15 vjet dhe barazohen. Cdo orë e punës duhet vlerësuar. Mekanizmi duhet ndryshuar në mënyrë urgjente.

Nga ky takim duhet të dalë një raport përmbledhës. Efektet financiare për reformën nuk janë relevante edhe pse ky do të jetë argumenti i ministrisë sepse duhet urgjentisht të reformohet sistemi dhe të unifkohen skemat dhe të ketë një sistem me frymë europiane.

Stazhi 15 vjecar, ekziston zgjidhja që nuk e ngarkon fare qeverinë, dmth futja e institucionit që e blen stazhin. Dmth për ata që nuk e plotësojnë këtë kuotë për një periudhe të shkurtë kohore, të blehet stazhi. Sa më shumë që ka për të blerë, shuma e blerjes bie tek blerësi. Sa më shumë që ai paguan ai, arka e shtetit përmbushet. Kemi të bëjmë me njerëzit që kanë të bëjnë me moshën e fundit të jetës.

Neni 8, pika 6 – dispozita "të tjerët" është shumë e qartë dhe ndryshe nuk mund të interpretohet deri sa të është në fuqi ai nen, përvecse të gjithë ata të shëndetësisë, të arsimit – shifeni absurdin – dhe veprimtaritë e tjera, edhe financimi, edhe format e tjera të kontributit që janë dhënë por që duhen verifikuar kanë të drejtë të trajtohen në këtë nen. Me ndryshim të ligjit përcaktohet. Unë e di si ka qenë puna e kualifikimit më herët. P.sh. kanë kryer veprimtari shumë të rëndë që kanë qenë e barasvlefshme me shkollimin e lartë. Kontributi i tyre ka qenë shumë i madh sepse kanë qenë shtyllë e zhvillimit VKA-ve. Prandaj, duhet t'u njihet njerëzve sepse është padrejtësi. Sipas udhëzimit administrative, tri kategoritë – të kualifikuar të lartë, të kualifikuar dhe të pakualifikuar janë futur në një vend. Ata që kanë kry magjistratura – a e dini cfare mundi është dashtë të studiohet nëpër Evropë e nëpër botë, e doktoratë. Pastaj data e diplomimit – janë të gjitha diskriminuese edhe rekomandimet e ILO-s e organizatave tjera. E kuptoj sistemin ekonomik, po është krejt diskriminuese.

Pse s'ka mundësi që personat që kanë punuar nga '99 deri në 2002 – pse të mos njihen kontributet? Shumë i mirë propozimi juj.

Folësi 3:

Dy cështje janë kyce këtu: ish-sistemi dhe skemat pensionale. Kosova nuk ka sistem pensional, vec skema pensionale. Të drejtat që kanë qenë në ish-sistem duhet të rishikohen dhe të përshtaten me rrethanat e sotme. Nuk ka databaza për krejt pensionistët pas '66, e për atë u marrë për bazë kategoria dhe kualifikimi, ose njëra ose tjetra. Pensioni në botë caktohet në bazë të të ardhunave, përjashtim u kon për individët që nuk kanë pasë 10 vjet të ardhuna personale. E mandej kush se ka plotësu kushti, u marr kategoria dhe kualifikimi.

'91shi duhet me u harmonizu me ligjin.

U përmend 60% i pagës minimale për pensionin bazë. Mendoj që osht parim në krejt shtetet e rajonit, dmth pensioni minimal osht 60% e pagës. Përvec për punëtorët e bujqësisë se Serbia e ka pensionin e Serbisë, nën 100 euro.

Pensioni kontributiv – unë e kom përkrah parimin e barazisë para ligjit dhe proporcionalitetit të ligjit. Me qenë të barabartë të gjithë se kemi të bëjmë me ish-kontributdhënës, me ish-të siguruar.

Pse parimi i proporcionalitetit – 15 vjet bojnë 180 muj, vec e ndan edhe e ki përqindjen mujore edhe e zbrit deri në 5 vjet, përfundi 5 vjet me ia jap ni rentë.

Pensioni invalidor i punës edhe pensioni familjar i punës – osht në kundërshtim total me të drejtën burimore të pensionit kontributiv. Duhet mu ndërru edhe me u harmonizu me logjikën.

Pagesa e lehonisë – duhet me hi në ligj.

Pensioni i parakohshëm – unë se kom ni hala naj ekspert që fol për legjislacion primar, sekondar. As vetë nuk e di cka osht FSK-ja, a osht pension i vecantë a i përgjithshëm. Se di ku ban pjesë. Parimet ndahen, pensionet sipas dispozitave të përgjithshme dhe të vecanta, mrena saj shpërndahen. E drejta në pension të veteranit – benefitet janë tjera. P.sh sipas dispozitave të vecanta, e kemi te policia, ligji i shkrum nuk mundet me u apliku. Nuk ka pension në botë pa dhanë kontribut.

Krejt trendet botërore janë kundër fondeve, as pensionin e parakohshëm.

Folësi 1:

Nuk e kemi përmend një cështje shumë serioze tash në kontekst të bisedimeve me Serbinë, po flasim për komunitetin, ASK, a kanë më shku këto të drejta në krejt territorin apo serbët po i përjashtojmë? Nësë krejt, është ni brengë. Nqs këto institucione, nëse jipen pensione kontributdhënës për të gjithë duhet me ditë që ky ka qenë vend colonial dhe kemi me përfundu tu i pagu disa serbë që (kanë qenë në ushtri të Serbisë).

Folësi 7:

MPMS.

Na kemi fillu kohët e fundit mu marrë ma intensivisht, sidomos na shërbyesit civilë m'i pa politikat pensionale pak ma ndryshe qysh po na e dikton politika me i bo e qytetari na drejtohet neve, tu e marrë parasysh që në Kuvend shpesh ndryshohen ligjet e në tekst mbesin kontradikta ligjore. Unë jam këtu prej 2007 kur ia ka fillu me u hartu ky ligj.

Ky ministër kur ka ardhë e ka skenu gjendjen e fushës edhe na konsultu neve që merremi me fushën edhe na ia kemi tregu gjendjen saktë edhe i kemi thanë a po doni me ndryshu gjendjen njëherë e mirë apo po doni si qeverite e kalume me bo ad-hoc politika që i kanë mbështet grupet e caktume. Ministri u tregu i vendostë që do me bo ni reformë të sistemit pensional invalidor dhe kemi fillu me bo në katër aspekte: legjislativ, me bo dmth ni ligj gjithpërfshirës; administrative, me kriju një mekanizëm, s'pe quj fond, i cili ka me mbledhë edhe ka me i zbatu të gjitha skemat, dmth e kemi konceptin One Stop Shop; teknik, me u kriju një sistem i avancuar teknologjik; ndërkombëtar, kur e kemi sistemin, i kemi edhe marrëveshjet bilaterale për sigurime dhe lidhim marrëveshje kontraktuale me vendet e tjera që me i transferu pensionet.

Na e kemi kriju një draft, concept-dokument, kemi arritë deri te do vija të trasha se na duhen ekspertë të cështjes që e njohin këtë fushë.

Na tu e ridizajnu sistemin kemi dalë te mbrojtja sociale, se po preken shtesat e fmive, ndihmat sociale etj., e po shohim që duhet me hy edhe aty. Na aktualisht jemi në procës të ridizajnimit të mbrojtjes sociale. Na po mendojmë me i nda pensionet kontributive prej jokontributive, me i ridizajnu shtyllat që i kemi, me kriju një shtyllë zero – pensionet invalidore, e tjerat cka janë para '99 me hi në shtyllën zero. Në shtyllën I me hi ndihmat sociale, lehonat e papuna dhe shtesat për fmi. Për krejt skemat duhet me i ridizajnu kriteret.

Shtylla e parë ka me qenë e kontributeve të punëdhënësve dhe punëmarrësve. Jemi tu i diskutu disa opsione, minimumin 3% që ka qenë edhe diskutim prej akterëve të ndryshëm, 5% edhe maksimumi 7%. Kur ta bojmë analizën duhet me pa sa na i zbret neve pagat se ka me pasë pakënaqësi të

shumta nëse zvogëlohet shumë paga. Shpëtimi i kësaj ka me qenë na që jena në marrëdhënie pune edhe kemi me vazhdu me kontribu në shtyllën 0 dhe në shtyllën e parë. Pas 10—15 viteve, shtylla e parë ka me qenë jo vec kursimet e moshës, kur të shterret kursimi i trustit kemi planifiku që me vazhdu deri sa të vdesë me marrë pensionin nga shtylla e parë. Kemi m'i parapa kriteret shumë strikt kush mundet me marrë.

Shtylla e dytë – ekziston mundësia me rujtë sistemin 5+5, nëse dojmë me liberalizu; e kemi diskutu edhe na që me ulë pagesën e trustit, 2 osë 3% edhe pastaj me rritë kontributin. Po gjithë tu ia bo ni analizë paraprake trustit dhe investimeve, me kqyrë a i kemi të sigurta hala investimet dhe trustit.

Shtylla e trete – nuk kemi ardhë hala këtu.

Ka me u kriju ni mekanizëm – fondi i sigurimeve sociale – se di a ka me mbajtë këtë emër, fondi ku pagujnë punëdhënësit dhe punëmarrësit; po ka m'i trajtu sigurimet sociale, ka me qenë në nivel të qeverisë ose i menaxhun nga ministria. Kjo agjenci ka me qenë agjencion që ka me i trajtu edhe pensionet. Pensionet për para '99 kanë me qenë fillimisht të mbulume prej shtyllës 0, po mendojmë me ia dhonë buxhetin tonë që e marrim prej kontributeve, me ia dhanë shtetit me i mbulu cështjet e shtyllës 0, se nëse e zbresim kriterin prej 15 vjet, ka me pasë kosto shtesë. Kjo skemë kushton diku 90 milionë, nëse e zbresim, kemi me pasë rritje. Nëse e futim edhe ligjin për pensione të policisë, ka me pasë rritje prapë. Na për nja 5 vite me ndihmu përmes shtyllës së parë.

Na po dojmë si ministri me kriju një kornizë të mbrojtjes sociale, me i vendosë minimumet, me i rregullu edhe ridizajnu të gjitha skemat, jo vec pensionale. Me i mbyllë cështjet e para vitit '99 që me mujt me edhe ai që ka punu 1 vit me iu njoftë.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL DEVELOPMENT COOPERATION

"Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)".